

Albatros Rexhaj

Zonja Z

Ky libër nuk është imi.

Është i Z-së dhe i mendimeve të saj.

Janë mesazhe, letra dhe shënime që ia kemi dërguar njëri-tjetrit. Mendime që i kemi ndarë bashkë në kulmin e intimitetit, atëherë kur dëshirat e epshet ia linin vendin ekstazave të shpirtit.

PROLOG

E dashuroja me gjithë shpirt dhe në këtë lojë tonën të dashurisë nuk kishte vend për asgjë tjetër. Në tiktaket e pandalshme të kohës, çdo gjë tjetër bëhej gjithnjë e më pak e rëndësishme. Pjesa tjetër e botës shlyhej nga regjistri i vëmendjes sime dhe i lëshonte vend Z-së.

Ajo u bë qendra e universit tim: Z-ja, vetëm Z-ja.

Shkrimtari shkruan për t'i dhënë kuptim lëmshit që ndien brenda vetes, ndërsa mua tashmë më mjaftonte Z-ja, ndaj edhe nuk ndieja nevojë që të shkruaja. Isha i lumtur dhe njerëzit e lumtur rrallëherë shkruajnë. Në universin e Z-së, nuk isha më shkrimtar. Nuk ekzistonin librat, nuk ekzistonin lexuesit, nuk ekzistonte ankthi i ëmbël në pritje të botimit të ri. Aty isha vetëm një shpirt i ngazëllyer dhe i ripërtërirë.

ËNDRRA E TAKIMIT TONË TË PARË

U përula si kalorës i kohëve të shkuara dhe buzët e mia
prekën lehtë lëkurën e butë të dorës së saj.

Një çast i vetëm, por rrufeshëm i thellë në ndjesinë e pakohë.

U ndjeva i vogël, para hijeshisë së asaj zonje të bukur. Aty
për aty, kuptova pse ndër vite e kisha adhuruar në heshtje, ende
pa e njohur.

Miliona imazhe m'u vërsulën, duke më mbërthyer në dehjen
e fantazisë së pakufi.

Një duet i përkorë.

Ajo e lodhur nga bukuroshët memecë, ndërsa unë i mërzhitur
nga kukullat e pagjak.

S'e kuptova sa zgjati ai çast, veç ndjeva kur ajo tërhoqi dorën
sakaq, ndërsa unë u përpoqa të mblidhja veten.

M'u duk se dallova diçka në buzëqeshjen e saj.

Mos vallë të dy kaluam nëpër të njëjtin vegim?

Ndoshta njeriu vërtet sheh vetëm atë që zemra i dëshiron.

RIGJETJA

Shqiptarët vazhdojnë të jetojnë në qerthullin e shtirjes
kolektive, ku mjerimi shitet si devotshmëri, ndërsa lumturia
kryqëzohet si një mëkat kardinal. Madje, përpjekjet për
ndryshim konsiderohen një lloj mëkati. Të jetosh në mesin
e këtyre njerëzve, është njësoj si të jetosh brenda një fluske
kohe, në të cilën kurrë, asgjë nuk ndryshon. Gjithçka lejohet
në mbrojtje të rendit të shëmtuar që sundon brenda saj. Kush
nuk pranon ta përqafojë mendësinë e fluskës dhe të mos heqë
dorë nga ëndrra e lumturisë, luftohet si të ishte ithtar i djallit
vetë. Meshkujt ëndërrimtarë stigmatizohen si të çmendur, të
shthurur apo perversë, ndërsa femrat ëndërrimtare damkosen si
të përdala, lavire dhe magjistrica.

Këtë fluskë, unë dhe Z-ja e përjetonim si një lloj purgatori,
ku ishim kurthuar të dy. Mjaftonte të mbyllnim sytë që të
takoheshim në labirintin e moskuptimit të qëllimshëm nga
të tjerët. Aty ku pasigurinë e ngujonim brenda heshtjes sonë.
Ndihehim të mpirë, nga lëndimi i botës që nuk na kursente,
por të qartë në ëndrrën që shihnim të dy. Mpirje dhe qartësi,
ky ishte paradoksi. Ky është sekreti që na mbante të lidhur
me njëri-tjetrin, sepse unë dhe Z-ja u takuam në kryqëzim të
botëve – aty ku jeta dhe vdekja përthithen me njëra-tjetrën. Të
dy ishim të lodhur nga shterpësia e fluskës që na ngërthente
brenda skemave të së shkuarës dhe nuk mund ta përballonim
më që jeta jonë të na shteronte para syve, pa ndonjë motiv.

Ka mënyra të ndryshme të vetëvrastjes. Unë dhe Z-ja kishim zgjedhur atë të vdekjes për së gjalli. Aq na bënte nëse në fund do të katandiseshim nën rrotat e ndonjë kamioni, do të binim nga ndonjë ballkon të dehur tapë a do të përfundonim në ndonjë tualet të pistë me një koktej antidepresivësh në dorë. Kjo s'kishte rëndësi. Që të dy e kishim humbur besimin se diçka mund të ndryshonte dhe se do të ishim të lirë të ndiqnim ëndrrat tona.

Ndonëse këtë nuk donim t'ia prananim vetes, ishim treguar qyqarë, sepse, në njëfarë mënyre, ishim dorëzuar. Ndryshe nga ata që përfundojnë në litar apo zgjedhin ndonjë mënyrë tjetër të shpejtë për të ikur nga kjo botë, për ne askush s'do të pyeste se çfarë na e kishte shtrënguar shpirtin; do t'ia vinin fajin alkoolit, drogës a tangërllikut tonë të nxitur nga të mirat materiale. Mes botëve ishte stacioni ynë i fundit, prandaj edhe s'kishim pse të nguteshim: kishim gjithë kohën e mundshme. Dhe në vend që t'ia ushqenim dëshpërimin dhe zhgënjimin njëri-tjetrit, bëmë të kundërtën – ndihmuam njëri-tjetrin të rigjenim magjinë e jetës. Në atë vend, ku mbase gjithkush tjetër do të gjunjëzohej në aktin e dorëzimit të fundit, ne zbuluam forcën e dashurisë.

Disa mendojnë se dashuria matet me pasionin dhe epshin, kujdesin material ndaj tjetrit, xhelozinë e shprehur apo ndonjë shenjë tjetër të tillë. Asgjë s'më bind. Kur dy vetë dashurohen vërtet, së pari janë shokë shpirti, bashkudhëtarë të sinqertë në çfarëdo rrugëtimi që zgjedhin. Ata flasin pareshtur, sepse çdo temë iu duket interesante dhe me vlerë.

Këtë bënim edhe ne: bisedonim për çdo gjë që na binte ndër mend. Unë kisha shumë pyetje dhe ajo tregonte mjaft durim me kureshtjen time. Ndodhte që këto biseda zgjasnin deri në

agim, aq sa më dukej se po jetoja netët arabe të Sheherazades. Kisha ndjesinë se po rizbuloja veten, atë vete që, nën presionin e zhgënjimeve të njëpasnjëshme, e kisha humbur diku përgjatë viteve. Isha si një fëmijë naiv para fshehtësive të jetës dhe delikatesës femërore. Pak para agimit, ngërthehesim me njëri-tjetrin për ta pritur mëngjesin të përqaftuar. Ajo strukej në gjirin tim, më mbështillej fuqishëm rreth belit, ndërkaq unë e shtrëngoja, a thua se trembesha se dikush do ta grabiste.

Dhe nëse do të më pyesje pse Z-ja ka pasur një ndikim kaq të madh mbi mua, do të të përgjigjesha me vetë fjalët e saj:

"Mos u shmang para asgjëje! Por sprovoje forcën tënde në çdo gjë që ta ngacmon shpirtin, sepse jeta nuk është një proces të cilin duhet ta kalosh në pritje të diçkaje që mund të mos vijë kurrë. Shprishe të rëndomtën dhe sfidoje përditshmërinë! Njeriu duhet të jetojë me pasion dhe me guxim, sepse përndryshe është vetëm spektator në këtë botë."

E di fort mirë, mendimet e Z-së nuk janë zbulime revolucionare; ajo flet për ato gjërat që të gjithë i dimë, të gjithë i ndiejmë dhe i jetojmë, por pak nga ne i shprehin. Por, ndryshe nga të tjerët, Z-ja nuk hesht. Ajo refuzon që të jetë një kukull e bukur dhe e pafjalë. Pavarësisht çmimit që duhet të paguajë, ajo rreket ta mbushë jetën me fantazi e t'i shkojë gjer në fund pasioneve të saj. Andaj, në sytë e puritanëve të qëmotshtëm, ajo është një heretike, vazhduesja e lojës së gjarprit në kopshtin e parajsës.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Unë: Të thonë: "Ndiqe zemrën!" Pastaj të godasin pa mëshirë dhe zemra të bëhet si një pasqyrë e thyer copë e grimë, e shpërndarë kudo... Si mund ta dallojë njeriu atë pjesëz që do ta bëjë të lumtur?!

Zonja Z: Nuk mundet. Askush s'e di nga marrin copëzat e si shndërrohen.

Unë: Është e lehtë t'u japësh mend të tjerëve: "Jepi fund lidhjes dhe vazhdo jetën!" Vetëm ata që e kanë provuar vetë e dinë se sa e vështirë është. Dhe edhe më e vështirë është që pas kësaj t'ia nisësh nga e para.

Zonja Z: E di! Zemra nuk është prej hekuri që të nxehet dhe të ftohet, të lakohet, të thyhet dhe përsëri të ngjitet.

TAKIMI I PARË

Takimin tonë të parë e kujtoj njësoj sikur të ishte pjesë nga filmi im më i dashur. Ajo pjesa më e bukur dhe më e fuqishme emocionalisht ku, nën ndikimin e muzikës dhe efekteve speciale, kupton se po ndodh diçka magjike.

Nuk e di nëse ndonjëherë ke përjetuar atë situatën ku një i panjohur, të cilin sapo e ke takuar, të bën të ndiesh se njiheni prej një jete. Nuk e ke parë kurrë dhe as nuk di gjë për të, por, megjithatë ti ndien diçka. Diçka të shkruar në ngjyrën e syve dhe të fshehur në hijëzimet e buzëqeshjes. Një ndjesi të njohjes, të koduar në ngrohtësinë e një shkëmbimi të rastësishëm shikimesh. Aty për aty, ke ndjenjën se një forcë e mistershme të ka bartur në një dimension tjetër dhe se i gjithë universi po përpiqet të të tregojë diçka. Diçka që buron nga amshueshmëria vetë dhe që mund të kuptohet vetëm me gjuhën e pafjalë të shpirtit. I mbërthyer në këtë ndjenjë, nuk mund të bësh asgjë. Belbëzon. Por fjalë nuk nxjerr dot.

Kështu ndihesha atë mbrëmje, përballë Z-së. Ajo ishte me dikë tjetër, një mëtues nga ata bukuroshët fjalëpakë, i cili bënte të pamundurën që ta impresiononte. Nuk e di pse ajo zgjodhi ta injoronte atë dhe vazhdimisht gjente një mënyrë të më bënte të kuptoja se vëmendjen e kishte tek unë. Në intervale pothuajse ritmike, krejt shkurt dhe të dy duke u shtirur se fajet i kishte rastësia, vështirimet tona përplaseshin me njëri-tjetrin. Sa herë që ndodhte kjo, në fytyrën e saj shfaqej një buzëqeshje e lehtë

dhe për të gjithë të tjerët pothuajse e padukshme, por që mua më mjaftonte për të ma përçuar mesazhin se asaj po i pëlqente kjo lojë.

Vloja, shpërtheja në heshtje, digjesha dhe shkrumbohesha nga ndjesia që Z-ja po më jepte atë mbrëmje. Dhe kjo nuk kishte të bënte aspak me bukurinë e saj që, dorën në zemër, secilit të vdekshëm ia merr frymën dhe as me epshndjelljen misterioze të saj, që jam shumë i bindur se edhe të vdekurin do ta ngjallte për ta dëshmuar veten në një betejë të fundit.

Jo. Kjo ishte krejt diçka tjetër.

Ishte diçka që buthtonte nga e pazbërthyeshmja e kësaj bote, që nuk mund të shprehet as me fjalë dhe as me diçka tjetër dhe që Z-ja tërë kohën e ndiente brenda vetes e nuk ia tregonte askujt. Madje as atij mëtuesit ambicioz që kishte përballë. Prandaj Z-ja po më buzëqeshte, sepse e dinte që unë po e ndieja të pazbërthyeshten brenda saj.

Që nga ajo mbrëmje vazhdimisht e rigjej sekretin e saj, atë që të gjithë meshkujt, sado kryelartë dhe të pashëm që mund të jenë, i kthen në skllëvër të heshtur të saj. E jetoj në çdo frymë timen.

ARMIKU I PADUKSHËM

(mesazh për Zonjën Z)

Përsëri po bie shi.

Një shtrëngim vetmie më kaplon zemrën.

Ndihem i zbrazët dhe pa frymëzim.

Kërkoj arsye (justifikime më tepër): "ky dreq moti më err mendjen".

Dhe i mpirë, rri me sytë ngulur në bosh.

Nuk e di se çfarë pres, di vetëm se pritja më lodh.

Më rraskapit si një armik i padukshëm.

Më gërryen nga brenda në heshtje.

PARA Z-së

E sugjestionojmë veten se nuk mund të ngrihem mi në këmbë, se bukuria nuk na bën më asnjë përshtypje. Vullnetshëm arratisemi në një botë imagjinare, edhe pse e dimë që ajo nuk na fsheh dot. A mund të fshihemi nga vetja jonë? Ia dimë përgjigjen kësaj pyetjeje, prandaj edhe heshtim; ajo vetëm sa na shton inatin. Ndërkohë diçka na shtyn të bëjmë gjëra të çmendura, që, aty për aty, na duken sfiduese, ngazëlluese, por që trishtojnë. Gjithçka, vetëm që të harrojmë. Më pas e urrejmë veten për kokëkrisjet tona, pasi e dimë që problemi është diku tjetër. Është diçka që na gërryen në thelb dhe që nuk mund të zëvendësohet me asgjë: kemi humbur besimin në dashuri, ndaj i largohemi jetës.

Para Z-së, kështu isha, njësoj si shumë të tjerë që mbushin *pub*-et dhe klubet e natës. I hidhëruar me tërë botën, festoja në dehje dhe dafrunga pafund. Qeshje dhe lot. I paaftë që të kuptoja se ku mbaronte njëra dhe ku niste tjetra. Por netëve, kur heshtnin zhurmat që më fshihnin nga bota, atëherë më zinte pusi jeta ime e vërtetë: I kisha të gjitha dhe përsëri ndihesha thuajse pa asgjë; bëja shtatë palë qejfe dhe përsëri ndihesha i trishtuar; më dëshironin, por unë nuk dëshiroja askënd. Gjithnjë isha në kërkim të diçkaje, ndonëse nuk e dija saktësisht çfarë dhe ku ta kërkoja. Mungesa më vinte herë në trajtën e një dore ledhatare, që më fshikte në dremkat e mia e më bënte të hovja i trembur, herë në trajtën e një siluete të pakapshme, që nata ma

formësonte e dita ma zhbënte. E megjithatë kisha pak besim se kjo gjendje mund të ndryshonte. Isha zhgënjyer aq shpesh në jetë, sa që nuk besoja më se diku ekzistonte njeri për mua.

Meshkujt përgjithësisht janë të etur për të pasur sa më shumë përvoja dhe partnere seksuale. Ky është dëfrimi kryesor për ta, madje, për disa është edhe maksimumi i ambicies. Doemos, pakëz i tillë isha edhe unë, por, përpos këtij instinkti për shfrenim, unë ëndërroja që një ditë të takoja një grua, me të cilën të dashuroheshim pa kushte, pa e vrarë mendjen për të tjerët. Të lirë.

Gjatë bredhjeve të mia nga një shtrat në tjetrin, e ndieja se më shumë jepja, sesa merrja. Prandaj, me kalimin e kohës, fillova të krijoja distancë ndaj çdokujt. Nisur nga vetja, nga neglizhenca që kisha treguar ndaj ndjenjave dhe shtytjeve shpirtërore, bëja supozimin e gabuar se kështu duhej të ishin të gjithë. Nuk u besoja femrave, sepse, në radhë të parë, nuk i besoja vetes sime. Kërkoja femrën ideale, edhe pse vetë isha shumë larg mashkullit të përkryer.

DUA TË BESOJ

“Do të më intrigonte ajo femër që nuk do të mjaftohej vetëm me vëmendjen time. Dikush që do të kërkonte diçka më shumë nga unë, nga vetja dhe nga jeta. Do të dorëzohesha përballë asaj që nuk do të ndalej para asgjëje, që nuk do të turpërohej nga natyrshmëria e vet. Por druaj se kjo është vetëm një ëndërr dhe se një femër e tillë ekziston vetëm në filma dhe romane.”

Këto fjalë i kam shkruar para se të takoja Z-në, në një kohë kur vërtet besoja se në këtë botë nuk mund të ekzistonte dikush si ajo. Por, sapo e takova dhe këmbeva disa fjalë me të, e ndjeva se Z-ja ishte ajo që do t'u bënte hije të gjitha femrave të tjera të jetës sime. Asaj do t'i dorëzohesha.

Atë ditë i shkrova një mesazh:

“Nuk dua të bëhem aq i pafuqishëm sa mos të të mohoj dot asgjë.

Nuk dua që zemra ime të jetë një lodër më shumë në kthetrat e tua.

*Grua leopard,
e egër dhe e pamposhtur.
Të lutem, më kurse!”*

Ajo e lexoi, por nuk më ktheu përgjigje. Për të ma shtuar kureshtjen apo për ta dëshmuar fuqinë e saj mbi mua, pak rëndësi ka. Më në fund kisha rastin të jetoja ëndrrën time,

edhe pse një pjesë e imja ende nuk e besonte dot krejtësisht. Përpëlitesha në dilema e dialogë pa përgjigje.

Tregomë, e dashur: ti, ekziston vërtet?

Duhet ta di.

Pa ty gjithçka tretet në çast, thuajse krejt bota pushon së qeni.

Nga frika sajoi arsye vetëm për të shkëmbyer një mesazh me ty.

Më duhet të ajros mendimet dhe shpirtin, sepse bëhet vapë dhe zagushi. Endem mes një mjegullnaje, nga zemra që më digjet prush dhe nga mendja që po më luan rrengje.

Më trego: ti, ekziston vërtet?

Duhet ta di.

Kam nevojë ta dëgjoj nga ti.

SINQERITETI

Sa herë që mendoj për gjithë të tjerat, të njohura para Z-së, më duken si personazhe të sajara, saqë, kur ndonjëherë ndodh t'i takoj rrugës, kam përshtypjen se nuk i kam njohur kurrë. Mbase kjo ishte arsyeja që për aq kohë sa kam qenë me to, ndieja se diçka mungonte. Diçka themelore që nuk mund të krahasohej a të zëvendësohej me gjë tjetër: sinqeriteti. Jo vetëm në raport me të tjerët, por edhe me veten.

Në teatrin e botës, ku të gjithë shtiren se janë të sinqertë, po të njëjtët, çuditërisht, përpiqen të të bindin se sinqeriteti në jetë nuk është edhe aq me rëndësi.

Paradoks! Të thonë: "Çfarë të duhet kjo, në një botë të rreme?"

Sikur harrojnë se pa sinqeritet nuk mund të ketë dashuri të vërtetë.

Z-ja është e vërtetë. E vërtetë në çmendurinë, mllëfin dhe zhgënjimin e saj, por, mbi të gjitha, është e vërtetë në raport me veten. Ky sinqeritet e fuqizon në karakter, e bën të lirë nga komplekset, prandaj ajo nuk turpërohet nga natyrshmëria e vet. Dhe një femër e tillë – e vërtetë ndaj vetes dhe e lirë nga komplekset – është ideali im: një grua leopard, një mbretëreshë e shtratit dhe një magjistrice e shpirtit.

Tërë jetën kam menduar se lumturia është diçka e paarritshme, por gjatë kohës që kalova me Z-në, e kuptova se

lumturia fshihet te ngrohtësia që të jep njeriu që ke në krah. Dikush që nuk të bëhet vetëm dashnór, por edhe bashkudhëtar shpirtëror në jetë. Një njeri që i jep kuptim ekzistencës sate.

Herë-herë, as vetë s'e kuptoj dot ç'ndryshoi Z-ja tek unë.

Është diçka intime që vështirë se mund të vërehet nga jashtë. Ka të bëjë me domosdoshmërinë që ndiej për të treguar vlerësim dhe respekt për femrën shqiptare, por edhe me nevojën që të jem i sinqertë për ndjenjat e mia, së pari në raport me veten e më pas edhe me të tjerët.

Z-ja ka një fuqi të jashtëzakonshme ndikimi, pasi ajo nuk flet nga një katedër boshe, fjalët e saj janë gatuar gjatë peripecive të shumta të vetë jetës së saj. Një femër e tillë të futet nën lëkurë dhe, dashje pa dashje, të bën të mendosh për gjithçka. Ajo të nxit të rishikosh veten. Prandaj, besoj se mirëkuptohem kur them se jeta ime ndahet në përgjumjen e lodhshme para Z-së dhe gjallërinë marramendëse pas Z-së. Ajo ishte kthesa. Këtë e kam ndier që në çastin e parë. Jam ngazëllyer, jam ndier i sfiduar, edhe jam trembur. E kam ditur, përtej çdo dyshimi, se Z-ja do të më ndryshonte në pakthim.

TREMBEM

(mesazh për Zonjën Z)

Dua të të dashuroj.

Të ta zbuloj edhe të fshehtën e fundit të zemrës.

Por e ndal veten.

Ngurroj, sepse kam frikë.

Dashuria ka pushtet përtej çdo kufiri.

Kjo më tremb.

MAGJISTRICA

Ne meshkujt jemi qenie të çuditshme. Atëherë kur epshi na pushton, ngutemi t'i futemi në shtrat një femre, thujse do të na ikë fryma e fundit. Por, pasi arrijmë atë që dëshirojmë, i kthejmë kurrizin dhe flemë. Një gjë e tillë nuk mund të ndodhë me Z-në, sepse ajo të mban në gjendje epshi të vazhdueshëm. Vetëm me fuqinë e fjalës dhe butësinë e gishtave, me disa pëshpërime të lehta në vesh e disa përkëdhelje në pjesë të harruara të trupit, ajo zgjon çdo atom, çdo qelizë, çdo shqisë dhe çdo ndjesi të trupit tim.

Nuk gaboj nëse them se ajo bën pjesë në ato femra që e meritojnë t'u thuren himne. Por, nëse do t'i thurja himne, atëherë ajo do të ishte si Laura e Petrarkës: një vegim surreal i mendjes dhe i shpirtit të poetit. Z-ja nuk është një Laurë. Ajo është një frymëzim që duhet të kërkohet përtej kufijve të fantazisë, qoftë ajo dhe fantazia e një artisti.

Artistët e vërtetë e ngjizin artin e tyre me dromca çmendurie e vërtetësie, duan edhe ëndrrën, edhe realen. Thonë se Mona Liza – ajo që në pikturë na e jep imazhin e një gruaje të fisme – në të vërtetë ishte dashnorja e fshehtë e Da Vinçit. Ajo na shfaqet e fshehur prapa imazhit të një bukurosheje që sfidoi kureshtjen e Da Vinçit dhe e ngacmoi atë përtej kufijve të çmendurisë së tij të zakonshme. Prapa qëndrimit të qetë dhe hijerëndë, fsheh vorbullën e një furtune të madhe që t'i çon peshë shqisat dhe ndjenjat.

Në sytë e saj fshihet një vullkan i pasionit të virgjër, të egër, të pastër.

Ka kohë që e vras mendjen: çfarë ngacmimi të fuqishëm duhet të ketë nxitur Mona Liza, që çmendurinë artistike të Da Vinçit ta zhvendoste përtej çdo kufiri të njohur për artistët e kohës? Besoj se ngacmimin sublim Da Vinçi e kishte zbuluar në shtrat, i mbërthyer në kthetrat e epshndjelljes dinake të Mona Lizës.

Z-ja më thotë se këto janë dërdëllitje të miat, se jam i dhënë pas iluzioneve të lidhjes mes gruas dhe magjisë së artit, se edhe vetë atë unë e përfytyroj eterike. Ndërkohë, ajo rreket të më bindë se është tokësore, e prekshme, por për mua mbetet Mona Liza ime, magjistrice e ndjesive të mia.

NUK DUA TË SHITIREM

(mesazh për Zonjën Z)

Pse të shtirem se nuk të dëshiroj?

Krejt çka dua është të jem afër teje.

Si një trup i vetëm, njësh me njëri-tjetrin, në harmoni ritmike, si çelësi dhe dryni magjik bërë veç për njëri-tjetrin.

Pse të shtirem se nuk të dëshiroj?

Dua t'i mësoj të gjitha dihatjet e tua.

Dua të jem ai që çliron pafundësinë brenda teje dhe para të cilit nuk turpërohesh për macen e egër që në të vërtetë je. Atë që ëmbëlsisht grith në delir dhe mjaullin për inat të fqinjëve.

Pse të shtirem se nuk të dëshiroj, kur vetëm afër teje e ndiej fundin e vetmisë sime.

PAFYTYRËSIA JOSHËSE

(shënimi i parë i Zonjës Z)

Mikeshat e mia thonë se një femër nuk duhet të tregohet kurrë e sinqertë me mashkullin e zemrës, pasi atij do t'i rritet mendja. Kurse unë dua të të tregoj pse ti je i rëndësishëm për mua.

Më pëlqen sepse je artist, por jo vetëm kaq. E kam ëndërruar një mendimtar në jetën time: dikë që di t'i japë kuptim çdo rrethane. Por rëndom, mendimtarët janë shumë të mërzitshëm, prandaj ajo pjesa e artistit është e domosdoshme. Edhe mendimet më të sofistikuar kanë nevojë për pak zbukurim. Unë vlerësoj jo vetëm fjalën dhe veprimin, por edhe mënyrën si thuhet e bëhet ato.

Ke imagjinatë të bujshme, por njëherësh je edhe shumë dembel. Fshihesh prapa justifikimit se tërë kohën të duhet një frymëzim, edhe pse e di shumë mirë se ty nuk të duhet askush dhe asgjë. Më pëlqen kjo lojë jotja, dembelizmin tënd me çdo kusht do ta justifikosh me diçka, si një mënyrë që, pa u vënë re, ta vësh veten në qendër të vëmendjes.

Je këmbëngulës deri në kokëfortësi dhe joshës deri në cingërisje nervash. Është tërheqës një burrë që di ta përdorë kokëfortësinë e vet, nëse di ta dallojë kufirin e hollë midis asaj dhe të qenit një kokëderr i shpifur.

Je shumë i sjellshëm, jo vetëm para syve të botës, por edhe kur jemi vetëm. Më pëlqen që çdo ditë të më vardisesh, thua se duhet me çdo kusht që të ma fitosh zemrën edhe njëherë nga fillimi.

Je dhe i pacipë. Pafytyrësia jote është ndjellëse: ti as nuk përpiqesh ta fshehësh se tërë kohën mendjen e ke te seksi. Në sytë e tu shihet një dëshirë e përhershme, në çdo kohë dhe në çdo vend, sikur e ke shpirtin në fyt e nuk mund të presësh as edhe një sekondë të vetme. Veçse, kur bëjmë dashuri, ti nuk ngutesh. Pret, dëgjon frymëmarrjen time, ndien dhe më lë të kuptoj se aty je vetëm me mua dhe vetëm i imi.

Mbi të gjitha, më pëlqen që mes nesh, në mënyrë të natyrshme, mbin një botë e rehatshme, ku mund të jem vetvetja, pa frikë se mund të lëndohem. Ëndrra ime ishte të gjeja dikë me të cilin do të ndihesha e lirë. Sa herë që ne jemi bashkë, jam vetvetja: ashtu siç jam dhe ashtu siç dua të jem; as tepër e egër dhe as tepër e çiltër.

Ti je ndryshe. Meshkujt premtajnë lumturinë, por bëjnë pak përpjekje që t'i kuptojnë ato gjëra të vogla e të thjeshta që japin vërtet kënaqësi. Mjaftohen me dhurata dhe nuk e shohin të arsyeshme të japin edhe diçka nga shpirti i tyre. Nga thatësia e dhuratave të tyre, unë shndërrohem në mermer të ftohtë.

Më quan magjistrice, sepse arrij të të mbaj zgjuar, por nuk duhet ndonjë magji e madhe për ta bërë këtë. Pavarësisht imazhit që tërë kohën përpiqesh ta projektosh për veten – si njeri i sigurt dhe që kinse e di se çfarë bën dhe do nga jeta – e vërteta është se edhe ti, si shumë të tjerë, je një fëmijë i llastuar. Dhe fëmijëve u hapet goja për gjumë, por vetëm me një dredhi

të vogël ata zgjohen sërish deri në mëngjes. Pak përkëdhelje, pak fjalë të bukura dhe të tjerat më pas i bën vetë, sepse është në natyrën tënde të llastohesh. E megjithatë mua më pëlqen kur ti më quan magjistrinë.

Duke qenë se po ngulmon, do ta bëj atë që më kërkon. Të gjitha bisedat tona të netëve të vona do t'i mbledh diku.

Nuk e di se çfarë ke ndër mend të bësh me shënimet e mia, por, për aq sa kam mundur të të njoh, jam e sigurt se do ta ndjekësh pikë për pikë këshillën e Pikasos: "Një artist i keq kopjon, ndërsa një artist i mirë vjedh." Por nuk do ta zë për të madhe edhe nëse i "vjedh" shënimet e mia. Këto mendime nuk janë vetëm të miat, këto mendime janë edhe të tuat.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Zonja Z: U shfaqe atëherë kur po prekja fundin. Mjafton vetëm të të mendoj dhe ndihem mirë.

Unë: Të gjeta kur kisha humbur besimin. Ti je frymëzimi im.

Zonja Z: Përgjithmonë dua të jem muza jote.

Unë: Ti je më shumë se aq. Sa herë të kam afër, ndiej diçka që më kthen në vrullin e ëndrrave të para. Nuk përmbahem dot. Gjithçka brenda meje më shtyn të thërras emrin tënd.

MISTERI Z

Diç nga brenda më shtyn të tregoj sa më shumë për Z-në, ndoshta ngaqë dua t'ia shpall gjithë botës ç'ndiej për atë, por atëherë ajo s'do të ishte më muza ime e fshehtë që, me magjinë e saj, ka ringjallur shpirtin tim të fikur.

Nga ana tjetër, druaj për të; druaj sepse njerëzve vetëm duke gërmuar në jetën e të tjerëve, iu bëhet më i durueshëm boshllëku i jetës së tyre. Cinikë dhe gjykues. Shtrigat nuk digjen më në turrë të druve, por njerëzit vazhdojnë të jenë plotësisht të aftë ta lëndojnë dikë përtej asaj që mund të durohet, aq sa ta bëjnë të dojë të hidhet vetë në flakë.

Nuk është aspak e rëndësishme se kush është Z-ja, si emër i përveçëm apo si figurë që mund takohet në rrugët e kryeqytetit. Nuk jam dashuruar me të për shkak të bukurisë a të ndonjë tipari tjetër të dukshëm, prandaj, edhe sikur të tregoj se cila është, pakkush do ta kuptonte delikatesën e frymëzimit tim.

Jam dashuruar me atë që jetonte brenda Z-së.

Me gjithçka ajo ndante me mua çdo mbrëmje.

Me guximin e saj që nuk e kam hasur tek asnjë femër tjetër.

Me gatishmërinë e saj që të bënte gjërat më të çmendura vetëm për mua.

Nuk ndienim nevojë që lidhjen tonë ta shpallnim. Thjesht dëshironim që të shijonim dashurinë tonë, të qetë, larg syve të të tjerëve, t'i kuronim plagët e shpirtit njëri-tjetrit. Ajo kishte nevojë për fjalët e mia, ato që shpërthejnë vetëm nga pasioni i pastër, ndërsa unë kisha nevojë për butësinë e shpirtit të saj.

Kjo ishte bota jonë, kaq na mjaftonte. Çdo gjë, çdokush tjetër ishte i tepërt.

KËPUCËT E KUQE

(shënim i zonjës Z)

Teksa po shkruaj, jam duke përjetuar natën e mbrëmshme.

Më the se ndiheshe shumë i trishtuar dhe tërësisht pa frymëzim. Pa paralajmërim renda te ti. Mbatha këpucët e kuqe me taka, ato që ty të pëlqejnë shumë. Hodha krahëve vetëm një pardesy ngjyrë qielli, aq sa për të fshehur lakuriqësinë time rrugëve.

“Ndiresh i frymëzuar tani” – të pyeta dhe vështrimi yt më depërtoi tejprtej.

Të ndiej si më afroresh tinëzar, thua se do të më zësh në befasi dhe kjo ma shton afshin. Ti e ndien këtë, më puth pandërprerë, nuk ndalesh. E ndiej se je i eksituar, fërkoresh mes kofshëve të mia plot padurim, që të më depërtosh. Por nuk ngutesh. Vazhdon të më puthësh, më përkëdhel flokët, krahët, gjinjtë, barkun... Tani jam unë ajo që nuk kam më durim; dua që ti të futesh brenda meje, por ti vazhdon të më puthësh në çdo cep të trupit, sikur do që të më shijosh të tërën në një përjetim të vetëm.

Shumë gjëra ndiej përnjëherë: lëngu i gojës sate më eksiton edhe më shumë; përkëdheljet e tua më shkaktojnë drithërima:

më duket se flutura flatrojnë brenda meje; vetëpërmbajtja jote më jep ndjenjën e një ankthi ekzaltues. Druaj se do të vërshoj, shtrëngoj çdo muskul në trup. Ti e ndien këtë dhe, sa herë që shtrëngohem, ti më kap dorën dhe gishtat e tu mbërthejnë të mitë. Dikush mund të thotë se jam budallaqe, jam romantike e pashpresë, por le të mendojnë çfarë të duan. Në heshtje, në ritëm me këngën që na pëlqen të dyve, të pyes ty: “A do të më duash edhe atëherë kur nuk do të jem më e re dhe e bukur?”

SIMFONIA E MESNATËS

(mesazh për Zonjën Z)

Ç'nuk do të jepja që sonte të isha afër teje. Të të mësoja artin e fjalëve të pakta.

Të të bindja se fuqia e pasionit nuk shpërthen nga epshi i vrazhdë, por rrjedh nga përkushtimi.

Çfarë nuk do të jepja që sonte të isha afër teje dhe të të mësoja notat e muzikës së shpirtrave rebelë.

Me simfoninë e mesnatës të të udhëheq deri në kulmin e ekstazës.

Dhe përsëri, përsëri, përsëri...

TË AKTROSH NË SKENËN E JETËS

(shënim i Zonjës Z)

Kur i filluam bisedat tona, ti nuk më pyete se çfarë mendoj unë për ty!

Të rrallë janë ata njerëz që i përmbahen tundimit për t'u vënë në qendër të çdo situatë. Më pyete si e shoh unë veten, doje të njihje pjesën time të fshehtë, atë që unë nuk ua tregoj të tjerëve. Më fute në mendime për veten, çka unë nuk kam shumë dëshirë ta bëj, sepse më hapen plagë të vjetra që pluhuri i harresës tashmë i ka mbuluar.

Thonë se jam një aktore e shkëlqyer. Kushedi, ndoshta në teatër dhe në film, mbase! Por për sa i përket skenës së jetës, me siguri jam e tmerrshme. Një artist i vërtetë mund të jetësojë me mijëra role, por refuzon të aktrojë në skenën e jetës. Loja i takon skenës dhe jo jetës reale. E vërteta e trishtë është se në jetën reale pothuajse të gjithë vendosin maska dhe hiqen sikur janë dikush tjetër. Sa keq aktrojnë! Në mesin e të gjithë këtyre aktorëve të këqij, një artist i vërtetë ndihet i humbur.

Ndihem kaq e lënduar. Shumë herë jam përpjekur të ruaj ekuilibrin, por gjithnjë singëriteti im më është kthyer kundër. Dhe e kam paguar çmimin për këtë, sepse, nëse nuk fshihesh

prapa një mburoje qoftë edhe të rreme, njerëzit e kanë shumë të lehtë të të lëndojnë.

Të tjerët, kur flasin për artistët, kanë dëshirë ta thjeshtëzojnë pikëvështrimin e tyre. Mjaftohen me fjalët "Artistët e shohin botën ndryshe". Por "ndryshe" mund të jetë gjithçka, përfshirë edhe gjërat më të shëmtuara. Pakkush beson se një artist e sheh botën si diçka të mirë. Madje si diçka më të mirë sesa realiteti. Prandaj dhe zhgënjehemi. Zhgënjimi sjell dobësinë; dobësia fton frikën, frika kurorëzohet me trishtim. Kjo është lakorja e dhimbjes shpirtërore që ndien një artist. Fillon nga diçka e vogël dhe sa vjen e rritet.

Në një botë të vogël, siç është bota jonë shqiptare, kjo shumëfishohet. Nuk është se ua vë fajin shqiptarëve, sepse pak prej tyre njohin një botë tjetër, pos asaj të dhimbjes, shtypjes dhe shfrytëzimit të tjetrit. Nuk i fajësoj as atëherë kur tkurren brenda frikës së tyre, si reagim ndaj çdo gjëje që është ndryshe; as atëherë kur si gërëzat e acaruar, armatosur me përgojime dhe thashetheme, turren ta zhvlerësojnë cilindo që tregon guxim ta jetojë jetën e vet ashtu si e ndien të arsyeshme. Nuk i fajësoj, madje e ndiej vuajtjen e tyre. Ama i frigohem vorbullës që krijojnë rreth teje, thashethemnajes që të vërsulet si ortek i pafre, që do të ndalojë vetëm pasi të të ketë shkatërruar.

Mund të përgatisësh çfarëdo personazhi për vete, por asnjë nuk bën punë, sepse vetmia dhe dhimbja duhen parë në sy.

Ti më pyet pse. Thua se një aktore do të duhej ta kishte të lehtë ta realizonte rolin e vetes.

Avokati që e mbron veten, do të duhej të kishte siguri. Mjeku që e shëron veten, do të duhej të dinte diçka më shumë,

në mënyrë që të shpëtojë veten. Aktori që e luan rolin e vetes, do të duhej të shkëlqente, por pse nuk ndodh kjo? Dhimbja e ndryshon artistin. Nga jashtë dukesh e njëjtë, por brenda është thyer diçka. Është thyer përjetësisht. Nuk duhet shumë mend për ta kuptuar se edhe aktorja më e mirë, mund të jetë e ngathët në skenën e jetës. Ashtu jam edhe unë.

Shpesh e pyes veten: Pse duhet ta fsheh dhimbjen? Pse duhet të shtirem se jam në rregull? Mos jam gjë e para grua e lirë mbi të cilën shoqëria ka hedhur baltë? Apo jetoj në iluzionin se do të jem e fundit?

Ndonjëherë më vjen të them: "Nuk jam e lumtur". Ndiej mërzinë në shpirt, ndiej dhimbjen e të jetuarit. Dua të flas! Të shprehem! Por ndalem, sepse më thonë: "Kështu jemi të gjithë. Mësohu!"

Çfarë ironie! Të mësohem! Me çfarë? Me robotizimin e të jetuarit?! Vetëm kaq mund të më japë kjo jetë?

E kur u jep zë mendimeve, s'vonon përgjigja e tyre e njëzëshme: "Ule hundën e s'ke për t'u lënduar e zhgënjyer".

Nuk kam fuqi të sajoj as edhe një buzëqeshje. Nuk kam fuqi, sepse kjo nuk është më ironi. Kjo është diçka patologjike. Vjen era vdekje. Kësaj i thonë të vdesësh për së gjalli. Nga dikush të shndërroresh në diçka! Në diçka që e harxhon kohën, që shtyn ditën. Një Zombi!

me ankthin e frikës dhe të dyshimit ndaj çdo gjëje të re. Më dha guxim për të parë atë që nuk ia pranoja vetes: vetë unë isha përgjegjës për fatin tim.

PËRMBYSJA E PIRAMIDËS

Përditshmëria jonë, e thurur nga shumë gjëra të imta, në pamje të parë të parëndësishme, heshtazi na e zë kohën dhe na e largon vëmendjen nga idetë e bukura. Unë e ndiej si një piramidë: çdo mëngjes më sfidon të pushtoj majën e saj. Por sado që të përpiqem, asnjëherë nuk ia arrij: maja zhvendoset lart për aq hapa sa ngjitem unë. I dërrmuar, çdo mbrëmje ndiej lodhjen në shpirt të më zymtojë.

E di se nuk jam i vetmi që ndihet kështu. Shumë prej nesh zgjedhin të heshtin duke besuar se një ditë vetvetiu diçka do të ndryshojë. Kam heshtur edhe unë, heshtjen e kam vlerësuar si një kompromis mes asaj që jetoja dhe asaj që ëndërroja. Kompromiset të imponohen në çdo hap dhe të vargëzohen si një lak rreth qafës që ta zë frymën. Mua ma ka ngulfatur shpirtin.

Z-ja më shryu të kuptoja se, sado të përpiqesha të mbaja ekuilibër me ligjet e pashkruara dhe traditat mbytëse, në fund do të isha vetë unë që do të detyrohesha t'i bëja kurban ëndrrat, ambiciet dhe dëshirat e mia.

Ajo e përmbysi këtë piramidë të lodhshme, hapi shtigje që nuk i kisha shkelur kurrë më parë. Më dëftoi rrugën drejt rebelimit, si nevojë për t'u mbrojtur nga përgjumja. Pa më pyetur dhe pa pritur leje, më çoi në labirinte të reja dhe të mistershme. Pasioni im për ndryshim shpërtheu njëkohësisht

TAKAT MBI ASFALT

(mesazh për Zonjën Z)

Si është e mundur që dikush si ti,

kaq e bukur dhe kaq tunduese,

të endet vetëm?

Nuk e sheh se të gjithë çmenden pas teje?

Madje edhe ai shitësi plak që të buzëqesh kur del nga pallati.

Edhe taksisti, që përherë është aty mbrëmjeve.

I tërë qyteti në ankth ndjek ritmin e hapave të tua.

Të gjithë i bëjnë veshët katër.

Deri në zemër i ndiejnë takat që kërcasin lehtë në asfalt.

Nuk e vëren se po digjem?

Shkrumbohem para vështrimit tënd,

si hi shprishem nën këmbët e tua.

PËRHERË VETËM

Z-ja nuk mund të çmohet nga të gjithë; ajo përfaqëson thelbin e bukurisë së pakapshme nga syri, atë që artistët tërë kohën përpiqen ta gjejnë. Si artist, nuk nxitem vetëm prej imazhit që kam përpara, sepse nuk e kam qëllimin të kap një çast të vetëm, një pikë në kohë e në hapësirë. Unë dua të kap amshueshmërinë: vetë energjinë e jetës që rrjedh, të ardhmen dhe të shkuarën të përjetësuar në një çast të vetëm.

Z-ja është si unë, por shumë më fisnike. Ka një shpirt të ndjeshëm, të butë, ushqyer përmes leximesh pa fund, sa herë-herë befasohem me përsiatjet e saj të thella mbi jetën. Është e lirë e mendjehapur, kryeneçe dhe e fortë. Për të, sipërfaqësorja është vetëm një verbëri e domosdoshme, një petk i varfër që s'tregon asgjë për thelbin e njeriut. Është thjesht shprehje e një nënshtrimi të vajtueshëm.

Z-ja nuk i honeps ata që mendojnë se gjërat iu takojnë vetvetiu. Janë po të njëjtit që i takojmë çdo ditë në rrugë, në punë, nëpër ballo, dasma dhe që plot siguri të përshëndesin me buzëqeshje të pakuptimta e të stërm-bushura me gëzim hipokrit. Z-ja e ka kuptuar se, edhe sikur ta provonte pafundësisht, kurrë nuk do të mund të bëhej pjesë e botës së këtyre njerëzve. Është armiqësore, ndaj tyre, por nuk e humb mirësjelljen. Armiqësisht e mirësjellshme! Diçka në dukje e përealizueshme, por jo për Z-në.

Prandaj edhe thotë: "Me hir a me pahir, je e detyruar të lundrosh në detin e trazuar të intrigave që na rrethojnë. Por ndonjëherë thjesht nuk mundesh më. Nuk mundesh pa u përlyer edhe vetë. Kështu që me dëshirë zgjedh të rri e ngujuar në bregun e vetmisë. Larg njerëzve. Larg turmave dhe energjisë së keqe të vetmisë që kamuflohet mes buzëqeshjeve të shtirura."

NDRYSHE

(mesazh për Zonjën Z)

Çdo gjë është ndryshe me ty!

Diçka që të fton ta vazhdosh kërkimin.

Mister që të deh.

Një forcë, përtej kësaj bote, që të rinon.

As grindjet nuk janë të lodhshme.

Aty ku të gjithë të tjerët do të përfundonin në ulërime, ne shpërthejmë në të qeshura dhe me sy i themi njëri-tjetrit: "Sa të marrë jemi!"

Çdo gjë është më e bukur me ty, e dashur!

Sa herë matem të ta them, si për inat, diçka ma lidh gojën.

Lëshohem në prehjen e melankolisë e trembem se, nëse ta them, atëherë do t'i zbulosh të gjitha sekretet e mia dhe do ta kuptosh se s'jam veçse një personazh i këngës A fool in love!

BOTË MË VETE

(shënim i Zonjës Z)

Më pëlqen kur më thonë “ti je botë më vete”, edhe pse e di se nuk është një kompliment. “Ti je botë më vete”, ashtu siç e mendojnë ata, do të thotë “ti je e çmendur”. Nuk jam e çmendur. Jam e lënduar, prandaj nuk dua t’ia di se çfarë mendojnë të tjerët. Fundja, ata nuk dinë pos të bëjnë një milion pyetje: Pse kështu? Pse ashtu? Pse pafund. Asgjë tjetër. Duan vetëm të shuajnë kureshtjen e tyre. Nuk është se mërzhiten vërtet për mua a për dikë tjetër. Njerëzit janë të shurdhër ndaj dhimbjes shpirtërore. Sot çdo gjë është vetëm interes. Ndoshta kështu ka qenë gjithnjë.

Jam botë më vete, por nuk do të thotë se jetoj jashtë saj. Mjaftojnë disa kujtime, të cilat më përcjellin vrazhdësinë e jetës dhe egërsinë e njeriut, që dita të më errët. Prandaj dua që t’i zbeh kujtimet dhe ta harroj të shkuarën time, thjesht dua t’i fshij të gjitha. Ndonjëherë më duket se ia dal, se vërtet nuk mbaj mend asgjë. Kam ndjesinë se vetëm JAM dhe se asnjëherë nuk kam jetuar prej vërteti. Ndihem e lirë, jetoj brenda një ëndrrë ku mjafton vetëm të zgjahem për t’u liruuar nga çdo ankth. Për aq sa zgjat kjo ndjesi, pyes veten nëse gjërat që kanë ndodhur, më kanë ndodhur mua apo dikujt tjetër?

Por, pavarësisht se më pëlqen të jetoj pa fantazmat e së shkuarës, e di se kjo s’është e drejtë. Ne jemi ata që jemi, pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve tona. Sa herë që përpiqemi ta amputojmë të shkuarën, nuk bëjmë gjë tjetër pos që amputojmë një pjesë të shpirtit tonë, duke zënë peng të ardhmen.

Në fund të fundit, sikur të mos ishin kujtimet, nuk do të kishim çfarë të tregonim. Sikur të mos ishte e shkuara, nuk do të dija se çfarë të ardhmeje të dëshiroja. Sikur mos ta kisha provuar egërsinë e botës, nuk do të dija të kërkoja një botë më të mirë, një botë ndryshe, një botë pa dhimbje.

KU TË GJEJ PREHJE?

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Ndiej nevojë ta ndaj me dikë tjetër barrën që më rëndon shpirtin, por e vetmja përgjigje që marr shpesh, është një fjali: "Mendo pozitivisht!"

Dhe kjo më fyen.

Nuk është se s'jam e aftë të mendoj pozitivisht, por më duhet diçka më shumë.

Më duhet një mbështetje.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Zonja Z: Të mbërthyer në zinxhirin e pasionit.

Unë: Të gjymtuar brenda një fluske me pak ajër.

Zonja Z: Përherë në kërkim të një qosheje ku mund të frymojmë lirshëm.

Unë: Ndiejmë vrullin e jetës.

Zonja Z: Ëndërrojmë për dashurinë.

ËNDËRRIMTARE?

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Imagjinoje veten si një femër të re dhe ëndërrimtare, si një femër që dëshiron të jetojë natyrshmërinë e vet. Në një botë si kjo jona, një femër që guxon të ndjekë ëndrrat e veta, është e paracaktuar të vuajë.

JO SI TË TJERËT

(mesazh për Zonjën Z)

Nuk jam si gjithë të tjerët: i dhënë vetëm pas bukurisë sate dhe i shurdhër ndaj furtunës që ushton brenda teje.

E ndiej shpirtin tënd kryeneç, e shoh në ty atë rebelen e adhurueshme që nuk dorëzohet para asnjë sfide.

Di ta lakoj heshtjen tënde, atë që ty tërë kohën ta shtrëngon shpirtin.

Sa duhet të pres që ti të kuptosh se nuk jam si të gjithë të tjerët?

Të dua ashtu siç je.

SHQIPTARI I VËRTETË?

(shënim i Zonjës Z)

Sot tërë ditën u lodha duke dashur të kuptoj pse mbrëmë u ndjeva një çupëlinë që nuk di asgjë as për jetën dhe as për meshkujt. Për çudi, pothuajse në çdo radiostacion, sot u dha kënga *Miracle of love*, thuajse dikush apo diçka po përpiquej të më përcillte një mesazh.

Ti nuk kërkon dashurinë time. Ti je aty me mua dhe je i lumtur për këtë, vetëm kaq. Sikur brenda shpirtit tënd gjithçka i gëzohet mundësisë që jemi bashkë, ndërsa çdo gjë tjetër thjesht ia lë rrjedhës së natyrshme të gjërave. Ti sikur më thua: "Stacioni ynë i radhës do të jetë aty ku të na dërgojë zemra dhe shpirti." Më parë mund t'i lexoja dhe t'i parandieja lëvizjet e dëshirat e meshkujve. Me ty ndihem gjithnjë e befasuar.

Unë besoj se ka meshkuj që vërtet synojnë të ngjizen me ty si në shpirt, ashtu edhe në trup. A thua ti të jesh i tillë?

Me humor të thashë: "A është e mundur që dikush të jetë si ti dhe në të njëjtën kohë të jetë shqiptar?"

Ti qeshe me mua dhe më the se, para se shqiptarët t'i thurnin këngë trimërisë, i kanë kënduar dashurisë. Ti më the se ndihesh shqiptar i vërtetë, një shpirt i lirë, i lindur për të shijuar bukurinë

e pastër të natyrës dhe jo ky version i arrogant e me kryelartësi të rreme që është krijuar ndërkohë. Dhe pastaj përsëri qeshe, sepse edhe ty, ajo që the, t'u duk shumë e ngatërruar.

A thua vërtetë ndonjëherë shqiptarët kanë ditur të jenë ndryshe e ta vlerësojnë të bukurën? Ti je i bindur se po, pasi thua se shenjtëria e femrës është e koduar thellë në kujtesën gjenetike të shqiptarëve dhe shprehet në të gjitha mitet e vjetra që e ngrenë femrën në nivel të kultit. Më thua se shqiptarët e vjetër, jo vetëm e donin femrën, por edhe e respektonin, përndryshe nuk do ta pranonin Teutën për mbretëreshë. Nuk e di. Mund edhe të ketë qenë kështu, por Teuta nuk do të ishte krenare apo e lumtur me shqiptarët sot.

JO SI NËNA IME

(shënim i Zonjës Z)

Ti më the se rebelët dallohen që në fëmijëri dhe se prandaj je kureshtar të dish se çfarë tipi isha e vogël.

Ky është një rast i mirë të të tregoj se si zhgënjimi i femrës shqiptare fillon që herët, sapo ajo bëhet e vetëdijshme për veten dhe gjininë e saj. Ende pa e njohur mirë botën, një femër shqiptare mëson se diçka thelbësore nuk është në rregull me vendin ku asaj do t'i duhet të jetojë. E mëson këtë atëherë kur i thonë të heshtë, pavarësisht se çfarë ka për të thënë; kur i thonë se duhet të rrijë në shtëpi, edhe pse nuk ka ndonjë gjë të posaçme për të bërë brenda; kur nëna i thotë se e ka merituar dhunën ndaj së cilës është nënshtruar e në shumë situata të tjera. Të gjitha këto i kam mësuar edhe unë. Ti ke shumë të drejtë kur thua se rebelët dallohen që në fëmijëri.

Në adoleshencë kam refuzuar të jem vajzë, sipas kuptimit që rrethi im i jepte kësaj fjale. Sipas dogmave të tij, ishte normale dhe madje e domosdoshme që një vajzë në adoleshencë t'i pranonte si të mirëqena të gjitha kufizimet që i ishin caktuar: kufizimi në zgjedhjen e shkollimit dhe në shprehjen e lirë të mendimit, pamundësia për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve në familje; të mos dalë rrugëve pasi të bjerë errësira, të shoqërohet vetëm me një mashkull dhe

atë vetëm pasi ta prezantojë në familje, të mos synojë gjëra që janë punë burrash dhe të tregohet e dëgjueshme kur i thonë se për kë duhet votuar, pasi nuk arsyetohet e drejta e saj për të ndjekur bindjet e veta. Lista vazhdon me shumë shembuj të tjerë dhe ka rrezik, për një çast, të na duket vetja se jemi kthyer në mesjetë, por farkeqësisht ky është realiteti ynë. Blejmë makina luksoze, ndërtojmë shtëpi të bukura, vishemi sipas modës së fundit, por në shpirt, aty ku vërtet peshohen gjërat, vazhdojmë të jetojmë me mendësinë e së shkuarës. Themelet e egra të pabarazisë midis gjinive shtrohen që në fëmijëri: brenda vetë familjeve tona dhe nga vetë prindërit tanë. Më pas, këto kufizime ngurtësohen në një dogmë pothuajse të pathyeshme.

Ende më kujtohet dita kur im ungj erdhi për vizitë dhe më dhuroi 500 lekë. Vëllait tim i dhuroi 1000 lekë. Kur e pyeta pse atij i dha më shumë, m'u përgjigj shkurt: "Ai është djalë".

Kaq. Asnjë fjalë më shumë.

Vështrova mamanë dhe jam e bindur se në sytë e mi ajo e pa lutjen time që së paku ajo të më dilte krah. Por ajo heshti dhe i uli sytë. Nuk besoj se mamaja pajtohej me dajën, por edhe ajo, si të gjitha gratë tjera të asaj kohe, nuk besonte se bota mund të funksiononte ndryshe. Që nga fëmijëria, ajo ishte edukuar që femra gjithnjë duhej të heshte.

Përballë heshtjes së nënës sime, përfytyrova të ardhmen time – çfarë do të bëhesha nëse edhe unë do të ndiqja rrugën e saj. E pashë veten të rritur, një grua shëmbëlltyrë të nënës sime: e pajtuar me të gjitha kufizimet, e dëshpëruar dhe e thyer nga padrejtësitë. Pastaj e pashë veten përballë vajzës sime, duke

heshtur dhe duke e ulur vështrimin, e frikësuar dhe pa kurajën për t'iu kundërvënë burrave në familje.

Dhe, aty për aty, u inatosa shumë, sa që kisha përshtypjen se mllëfi im po lindte nga barku i një bishe të lënduar, të egërsuar e të mllëfosur me të gjithë botën. Nuk e mbaj mend si ndodhi, por, para babait, nënës dhe dajës, e kapa vëllanë tim për fyti dhe e ngrita lart. Nuk e di prej nga më erdhi gjithë ajo fuqi, sepse vëllai im ishte dy vjet më i madh dhe trupmadh. Përballë mllëfit tim, ai ishte tërësisht i pafuqishëm dhe, sikur të mos më kishin kapur të rriturit, mbase edhe do ta lëndoja.

“Ç’pate moj? Ç’të gjeti?” – më bërtiti nëna e lemerisur, kurse babai dhe daja im më shikonin me habi.

“Qenka djalë ai! Merr më shumë ai! – fillova të bërtisja me të madhe: – Çfarë ka ai më shumë se unë?”

Që nga ai çast, u tret përfundimisht imazhi i vajzës që projektonte nëna ime. Që nga ajo ditë, më kurrë asgjë nuk ka qenë e njëjtë dhe me tërë qenien time, kam ndier se unë duhej të isha ndryshe.

Në muajt e parë pas kësaj ngjarjeje (kjo ishte koha kur gjinjtë sapo kishin filluar të më formësoheshin) nisa të vishesha si djalë dhe të rrihesha me secilin djalë të shkollës që kishte dëshirë të luante rolin e gangsterit të vogël. I shpërfillja të gjithë djemtë, sepse në sytë e mi ata ishin si vëllai im – mendonin se gjërat iu takonin vetëm se kishin lindur me atë veglën në mes të këmbëve dhe, kur të rriteshin, do të bëheshin si babai dhe daja im.

Duke u rritur, trupi im gjithnjë e më shumë po merrte formën e një femre të pjekur dhe fillova të kultivoja një ndjesi

tjetër, një më të fortë se mllëfi ndaj gjinisë mashkullore. Edhe pse doja të vazhdoja të shpërfillja, diçka në mua po frymonte ndryshe: shpirti i femrës po zgjohej brenda meje.

Nuk mund të isha më e egër ndaj tyre. Ata nuk ishin fajtorë për ndarjen e pabarabartë, por thjesht ushtronin rolin që sistemi i mbrapshtë u kishte dhënë. Edhe ata ishin viktimë të këtij sistemi: të llastuar dhe të përkëdhelur, të vënë në pedestal që në vegjëli, të trajtuar si idhuj dhe jo si njerëz, si burra. Duke u trajtuar përherë si qenie të adhuruara e të lëmuara, shumë prej tyre mbeteshin foshnja, të paafte për të ecur përpara në botën e të rriturve. Nuk ishte e nevojshme që të kacafytesha me të gjithë meshkujt, por mjaftonte që të mos bëja kurrë kompromise me veten, pasi ky sistem rregullash të qelbura funksiononte vetëm falë heshtjes së femrave dhe ndrydhjes së vazhdueshme të ëndrrave tona.

E kështu ndjeva se bota është plot me qerthuj ëndrrash që nuk jetësohen kurrë. Ëndrra femrash të ndrydhura e meshkujsh të tredhur. Ëndrra që barten nga viti në vit dhe që plaken bashkë me ne, deri në fund të rrugës sonë. Aty ku e mashtrojmë veten se sjellim ndër mend ato që kemi jetuar, ndërsa në të vërtetë kujtojmë ëndrrat që nuk realizuam kurrë e në heshtje, bëjmë pyetjen: Çfarë do të isha sot sikur...?

Me tërë qenien time, u betova se nuk do të lejoja që diçka e tillë të më ndodhte edhe mua.

Nuk do të heshtja. Kur ne heshtim përballë padrejtësive gjinore që përjetojmë në lëkurën tonë a shohim te të tjerët, meshkujt në fillim habiten, por me kohë mësohen, madje edhe fillon t'u pëlqejë, sepse heshtja jonë u krijon rehatinë e një bote

ku ata janë alfa dhe omega. Më mjaftonte të shihja prindërit e mi: heshtjen e vazhdueshme të sime mëje përballë tim eti.

Nuk do të ndieja kurrë turp për dëshirat, ëndrrat dhe shtytjet e mia. Pse duhej të gjykohesha a të gjykoja veten ngaqë dëshiroja një të ardhme, njësoj si edhe një mashkull? Pse duhej të përmbahesha dhe të mos shprehesha? Ku ishin të shkruara këto rregulla e këto kufizime? Pse çdo brez nënshtrohet para këtyre budallallëqeve?

Vendosa të bëj atë që të gjithë kanë dëshirë ta bëjnë, por që rrallë herë e marrin guximin: vendosa të dëgjoj zërin tim të brendshëm, të rebelohem.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Zonja Z: Nëse them se jam e mërzitur, menjëherë më radhisin një mijë arsye pse nuk duhet të ndihem kështu. Jam lodhur nga ata që presin nga unë të jem gjithmonë e përkorë. Dua të arratisem, të iki sa më larg.

Unë: Unë kam tërë jetën që po iki, por është e kotë. Edhe në fund të botës të arratisesh, dhimbja nuk tretet, duhet pranuar si bashkëbanuese në shpirtin tënd.

Zonja Z: Do ta pranoj. Por a mjafton kjo?

Unë: Jo, por nuk ka rrugë tjetër. Ky është ankthi i të jetuarit.

NJË ME GJAKUN TIM

(mesazh për Zonjën Z)

Jam lodhur nga bredhjet.

Më përkëdhel butë derisa të më marrë gjumi.

Më përqafu fort e mos më lësho as kur të zbardhë dita në mëngjes.

Bëhu një me gjakun tim, dua të di se jam i yti.

Dua të ndiej se jam gjallë.

MUNGESA E GUXIMIT

(shënim i Zonjës Z)

Të gjithë flasim për vrazhdësinë e realitetit ku jetojmë, të gjithë jemi viktimë. Duam të jetojmë ndryshe, të lirë nga maskat. Por, kur fjalët duhet të kalojnë në vepra, atëherë po të gjithë, në heshtje, sikur pajtohemi, nuk arrijmë të shkëputemi e thuajse kemi frikë se ky realitet është gjithçka që mund të kemi.

Ky realitet nuk është një kompozim virtual i gjërave që na imponohen. Nuk është një forcë e jashtme që e dhunon mënyrën tonë të jetuarit. Nuk është as një format rregullash të shkruara në gur. Është ajo që krijohet nga bilanci i maskave përballë fytyrave të vërteta. Gënjeshtër përballë së vërtetës, gjithsesi një proporcion i zhdrejtë. Një luftë e pabarabartë, epërsi e frikshme e mashtrimit mbi sinqeritetin.

Realiteti i egër është ai që ne krijojmë me heshtjen tonë, me mungesën e guximit për të sfiduar maskat.

E më pas ankohemi për pasojat e heshtjes sonë!

AJO

Ajo nuk hesht.

Guxon ta kërkojë hapësirën e mohuar.

Ajo është vullkan i pasionit.

Gjithnjë nxiton drejt lindjes së diellit dhe nuk ngurron ta shpalosë hijen e rëndë të mendjes së saj.

Ajo synon diçka më shumë.

Diçka përtej brishtësisë.

Diçka që atë e plotëson.

Ajo nuk mjaftohet me pak, sepse ajo është më shumë se një grua.

BESOJ

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Besoj se një ditë do të jemi vërtet të lirë.

Të lirë nga dëshpërimi ynë.

Të lirë nga frika, nga skamja, nga mosbesimi.

Të lirë nga udhëheqësit që na marrin për të mirëqenë; nga pasanikët e pasuruar shpejt pa asnjë konsideratë për jetën e tjetrit.

Të lirë edhe nga marrëzitë tona.

Besoj se një ditë e ardhmja do të jetë më e bukur këtu dhe jo diku tjetër.

Besoj!

E megjithatë, e di që besimi nuk mjafton.

VETMIA

(mesazh për Zonjën Z)

Nëpër natë i kërkoj dritat e qytetit tënd.

I dalloj gjurmët e tua.

Dhe e ndiej vetminë tënde.

Gjithsaherë eci rrugëve të qytetit,

që veç në dukje është i imi,

i huaj ndihem dhe unë.

E ADHURUESHMJA

Z-ja është më e gjallë se çdo femër tjetër që kam takuar ndonjëherë, më gjithë luftën e ndyrë me të cilën përballet, megjithë trishtimin, që ndien sa herë që ia copëtojnë ëndrrat. E adhuroj çmendurinë e saj. Jam i dashuruar me guximin e saj, me shkujdesjen e saj, me shpërfilljen që tregon ndaj meshkujve. Që në çastin e parë, u ndjeva i rrëmbyer nga ajo. Kishte një aromë tunduese që aty për aty më intrigonte. Pjekuria e saj! E dija se kjo pjekuri ishte gatuar me shumë përvoja dhe kjo më sfidonte, ma ngacmonte thelbin e burrërisë dhe turfulloja duke ndier një epsh që mezi priste të shpërthente.

Mos mendo se me fjalën “përvoja” jam duke nënkuptuar telashet dhe sikletet e jetës. E kam fjalën për të pathënat e të papranuarat e shoqërisë sonë ndaj një gruaje të re. Z-ja ka pasur shumë partnerë në jetën e saj dhe, në rrethanat tona të ngurta, ku forma vlen më shumë se përmbajtja, kaq mjafton që përgojuesit dhe hipokritët ta shpallin lavire. Z-ja është e drejtë. Madje shumë më e drejtë dhe më e sigurtë se ato puritanet e zhurmshme që orë e çast shesin moral për pak qindarka.

Z-ja nuk mbledh supet, nuk ul sytë apo nuk luan rolin e virgjëreshës. Ajo nuk ndihet në siklet përballë askujt. Meshkujve që i kalojnë pranë, u hedh një shikim të plotë, pa iu dridhur qerpiku. Ajo nuk i bishtnon shikimet, ashtu siç bëjnë rëndom ato “të ndershmet”, por me sigurinë e saj imponon respekt dhe çarmatos çdo Don Zhuan të sigurt në vetvete.

Nëse dikush i pëlqen, ajo vetë ia dëfton rrugën. Dhe të gjithë, të pushmë e të pushtetshëm, të famshëm, artistë dhe sportistë, që të gjithë i kanë shkuar pas. Si kaproj krenarë i kanë ndjekur shenjat drejt e në krevatin e saj me bindjen se do të bënin namin e do të dëshmonin veten si hamshorët e shekullit. Shumë pak prej tyre e kanë pasur një rast të dytë.

Vendosmëria e Z-së e bën atë edhe më tërheqëse. Pushteti i saj surreal, i cili imponohet falë qëndrimit të saj, i harlis meshkujt. Afshi i Z-së, i egër dhe në pamje të parë i papërmbajtshëm i ndez meshkujt si dema të harbuar, por stonon me fytyrën e saj të bukur që ngjan me ikonat e shenjtozeve. E shajnë dhe e përgojnë, por, në të njëjtën kohë, të gjithë ëndërrojnë ta shohin veten në shtratin e saj.

Asnjë prej tyre nuk ka kuptuar se Z-ja nuk donte një hamshor, por dikë që do ta përfshinte si në mendje, ashtu edhe në trup. Ajo nuk donte seks pa ndjenjë përjetësie, prej dashnorëve që marrin dhe nuk japin asgjë. Ndihej e zhgënjyer. E zhgënjyer me gjithë gjininë mashkullore për të cilën kishte humbur respektin. Me kalimin e kohës, re të zeza të trishtimit filluan ta errësojnë qiellin e saj. Ishte errësira e trishtë e mungesës së dashurisë. Ajo nuk kishte nevojë vetëm për dikë që ia plotësonte nevojat materiale. Kujdes të tillë marrin edhe kafshët e mbyllura në kopshtin zoologjik. Ajo kishte nevojë për dashuri dhe për besim në fuqinë e ndjenjave dhe të mendjes së saj.

MAGJIA E DASHURISË

(mesazh për Zonjën Z)

Ti më pyet se çfarë është dashuria për mua?

Një mendim i vetëm që i hesht të gjitha shtytjet e tjera.

Një qetësi në mendje.

Një uragan pasioni në zemër.

Një simfoni lumturie në shpirt.

Besimi fëmijëror se gjithçka është e mundur.

Magjia që jetoj, sa herë që jam me ty.

PËSHPËRITJE NË ERRËSIRË

Përtej çdo dyshimi, Z-ja donte të besonte se unë e dashuroja dhe se e pranoja për atë çka ajo ishte. E vërteta ishte se e dashuroja shumë më tepër sesa mund t'ia shprehja me fjalë, por, përkundër dëshirës së madhe dhe zgjedhjes me kujdes të fjalëve, nuk besoj se ia kam arritur t'ia shpreh.

Më pyeste sa e dashuroja, pse e dashuroja dhe si e ndieja unë atë. Donte të dinte për të gjitha fantazitë e mia, deri në detajet më të imëta. Dhe më pas, sa herë që bënim dashuri, më kërkonte që të gjitha t'ia pëshpëritja në vesh.

“Kur m'i shpreh ndjenjat dhe më tregon për dëshirat e tua deri në hollësi, më ndez flakë më shumë se të gjitha gjërat më epshndjellëse që kam provuar deri tani,” – më thoshte ajo.

I përvdhesha nga anash dhe i pëshpërisja për të gjitha ndjenjat dhe fantazitë e mia, e ndizesha edhe unë si asnjëherë më parë. Vazhdoja kështu derisa ajo më vendoste gishtin tregues mbi buzët e mia si për të më thënë se tani dëshironte që të gjitha sa i kisha pëshpëritur, t'ia përktheja në gjuhën e pafjalë të puthjeve, ledhatimeve dhe gjithçkaje tjetër të butë e të këndshme që mund të më binte ndër mend. Vetëm atëherë më lejonte që ta përfshija të tërën. Në të vërtetë, ishte ajo që më përfshinte mua.

KURSEMË

(mesazh për Zonjën Z)

Të lutem, mos më pyet se çfarë je ti për mua!

Për ta bërë këtë, do të më duhej të shqyeja krahavorin tim që ti të ndieje se si tërë kohën zemra ime thërret vetëm emrin tënd. Nuk mund as të të kthej prapa në kohë që ti të shohësh se si isha unë më parë: i mbërthyer në kthetra të përditshmërisë mbytëse; vetëm një frymë më shumë që endej poshtë e lart bulevardit.

Mos më pyet se çfarë je ti për mua!

Nuk di si të ta tregoj, sepse, për ta bërë këtë, do të më duhej që ëndrrat e mia të t'i shfaqja ty dhe ta shihje veten si shkëlqen në secilën prej tyre. Të bindeshe se edhe në ankthe, mendoj vetëm për ty.

Kursemë nga kureshtja jote, sepse nuk kam forcë të të mohoj asgjë. Dhe do të më duhet të sajtoj ndonjë fjalë të madhe, por përsëri, as atëherë, nuk do t'i avitem së vërtetës që flakëron zemrën time.

E vetmja gjë që mund të të them, është se ti më mbush me jetë.

Të lutem, mos më pyet!

T'I DUASH DERI NË URREJTJE

(shënim i Zonjës Z)

Mbrëmë the se dëshiron të dish çfarë mendoj për meshkujt që kam njohur.

Pata përshtypjen se prapa kësaj pyetjeje fshihej dëshira jote për të kuptuar pse kam pasur shumë partnerë në jetën time. Nuk është se kjo më habit, sepse këtë pyetje ma bëjnë shumë veta, por do të më habiste nëse edhe ti do të më gjykoje për këtë. Më duket se as ti nuk po i shpëton dot ethes së rrëmimit në jetën e tjetrit.

Në këtë rreth tonin, të vogël e të mbingarkuar me paragjykime dhe tradita shterpe, qoftë edhe vetëm dy meshkuj konsiderohen shumë.

Në fillim, atëherë kur sapo kisha filluar akademinë e arteve, pak e shtyrë nga kureshtja dhe pak nga dëshira që të tregohesha e rritur, mendova të shkoja me këdo që më eksitonte – diçka që ju meshkujt e bëni tërë kohën. Por, sado që e kam ndier tundimin të sillesha si një mashkull, jam lëshuar vetëm në krahët e atyre që kam menduar se mund të më jepnin diçka, pasi e kisha të pamundur të imitoja harbutërinë e një mashkulli. Nuk do të flas me numra, sepse, në fund të fundit, jeni ju meshkujt që mbani evidencë dhe numrat i përdorni për të treguar burrërinë

tuaj. Të paralajmëroj se diplomacia asnjëherë nuk ka qenë një nga pikat e mia të forta, kështu që mund të të dukem e ashpër.

Të them të vërtetën, habitem se si ka ardhur puna që sot botën ta sundojnë meshkujt. Mos më keqkupto! Nuk kam qëllim t'i shaj meshkujt. Dua vetëm të tregohem e singertë për çfarë është e dukshme kilometra larg.

Një pjesë e meshkujve janë qenie shumë të parashikueshme. Kjo kategori burrash, gjysmë fëmijë, nuk ka prirje për intrigë dhe as durimin e duhur që gjërave t'u shkojë deri në fund. E gjithë bota e tyre ndërtohet rreth projeksionit të një force të vrazhdë, që vetëm nga jashtë duket e fuqishme. Pavarësisht dekorit, vrazhdësisë dhe projeksionit të fuqisë, në të vërtetë kjo botë mashkullore është e parashikueshme dhe, si rrjedhojë, është e brishtë. Këta janë ata që thonë: "Femra e ka futur djallin në shishe", sa herë ballafaqohen me një femër të fortë. E mua më vjen t'u përgjigjem buzagaz: "Edhe djalli është mashkull, përndryshe nuk do të ishte aq naiv sa të lejonte që dikush ta fuste në shishe."

Këta janë po ata që herë pas here projektojnë imazhin e dikujt që është sipërfaqësor. Përballë një femre të bukur, pa një pa dy, këta fishkëllejnë dhe thonë: "Uuuu, çfarë pidi!" Qëllimshëm, që ta reduktojnë qenien e saj shpirtërore dhe fizike në një organ të vetëm. A të ka rastisur ndonjëherë ta dëgjosh një femër duke thënë: "Uuuu, çfarë kari!" Nëse ndodh, me siguri tipi të cilit i referohen është trap në katror.

Këta që bëjnë kështu, që vrazhdësinë e kanë recetën e tyre të preferuar, mendojnë se me fjalët dhe gjestet e tyre të pista e joshin një femër. Çfarë paradoksi! Duhet të jesh idiot i madh që

të besosh se kështu bëhesh më joshës. Këta, edhe sikur të duan, nuk janë të aftë ta kuptojnë një femër.

A do të ma zësh për të madhe pse i përdora ato fjalë? Ndoshta edhe ti, si mashkull shqiptar që je, mund të më kritikosh pse përdora po të njëjtat që ju i përdorni tërë kohën. Hipokrizia juaj nuk përfundon me kaq, sepse jeni vetë ju meshkujt shqiptarë, burrorë, krenarë dhe të gjithëdijsëm që tri fjalët më të njohura dhe më të përdorshme i keni fshirë edhe nga fjalori i gjuhës shqipe. Nëse nuk më beson, shfletu fjalorin dhe kërkoji. Nuk do t'i gjesh!

Sipas fjalorit zyrtar të shqipes, këto fjalë nuk ekzistojnë. Ndonëse i përdorin të gjithë. Ky është treguesi më i madh i pasigurisë së mashkullit shqiptar. Bijtë e këtij morali të rremë zhyhen sot nëpër rrugët e Tiranës duke trembur gratë, të mëdha e të vogla, e duke u fshehur prapa ideve shterpe të turpit dhe tabuve.

Ndërkohë, askush nuk bën as përpjekjen më të vogël që të korrigjohet kjo hipokrizia. Apo ndoshta i vetmi mashkull me dinjitet në këtë vend është prof. Tupja¹, që hoqi të zinë e dhesë duke e punuar fjalorin e tij të famshëm erotik.

Disa meshkuj të tjerë nuk dinë si t'i qasen zemrës së një femre.

Ky lloj mashkulli rreket të të futet në zemër me detyrim, thuajse ia ke borxh dhe patjetër duhet t'i bindesh. Zemra e askujt, por sidomos zemra e një femre, nuk hapet si një kasafortë.

¹ Fjala është për shkrimtarin, përkthyesin dhe publicistin shqiptar Edmond Tupja, autor i fjalorit të vetëm erotik të gjuhës shqipe (të gjitha shënimet janë të autorit).

Nuk mjafton të kesh çelësin apo të dish fjalëkalimin. Një femre mund t'i futesh në shtrat, por nuk do të thotë se ia ke fituar zemrën. Një shans e ka vetëm ai që e di se një femër nuk është në kërkim të një hamshori, por në kërkim të një mashkulli që do të dijë t'i futet edhe në ëndrra, përveçse në shtrat.

Shumë meshkuj shqiptarë, të çfarëdolloj kategorie, halabakë e intelektualë, të bukur e të shëmtuar, artistë e shpirtishterpë, të pasur e të varfër, duhet të kuptojnë se e kanë të domosdoshme mësimin e gjuhës së zemrës. Duhet të dinë të komunikojnë me këtë gjuhë, sidomos kur partnerja është e zhgënjyer dhe nuk beson më në dashuri. Një femër që e ka humbur besimin të dashuria, është si dikush që ka qëndruar shumë gjatë në errësirë, prandaj me shumë kujdes duhet ta bindim të dalë në dritë.

Një femër e lënduar nga dashuria mund të shërohet vetëm nga dashuria. Kjo është formula dhe nuk ka tjetër, sepse dashuria është i vetmi ilaç kundër frikës dhe dhimbjes. Këtë mund ta bëjë vetëm dikush që është fisnik në shpirt, dikush që di ta flasë gjuhën e zemrës.

Ti thua se femrat shqiptare nuk janë realiste në shpresat që ushqejnë.

Po flet si një mashkull tipik shqiptar që qëllimshëm refuzon t'i njohë finesat delikate të shpirtit femëror. Natyrisht, femrat nuk janë realiste në shpresat e tyre, përderisa kanë të bëjnë me një tufë egërsirash.

Çdo femër mund të dashurohet me një mashkull për shumë cilësi, por më së shumti ajo tërhiqet nga guximi i një mashkulli. Ajo ka nevojë për një hero që do të luftojë për lumturinë e saj.

Me fjalë të tjera, shumë meshkuj shqiptarë nuk dinë t'i qasen zemrës së një femre, jo për shkak se janë të padijshëm, por sepse janë përtacë dhe të vetëmjaftueshëm. Nuk e ndiejnë të arsyeshme që të përpigjen ta shohin botën nëpërmjet syve të saj, janë të bindur se të gjithë të tjerët ndajnë pikëvështrimin e tyre për botën. Mbase është në natyrën e mashkullit që të kërkojë nënshtrimin e tjetrit edhe atëherë kur shpreh dashuri. Sipas meje, në dashuri ka vetëm vetëdorëzim dhe nuk ka nënshtrim. Dashuria është art i shpirtit, sepse shpirti nuk do t'ia dijë për asnjë lloj shtrëngimi.

Meqë po flasim për këtë temë, ky është një rast i mirë të të tregoj se çfarë më irriton te ca meshkuj shqiptarë.

Nuk më ka ndodhur asnjëherë që partneri im shqiptar të mos më bëjë pyetje për meshkujt para tij. Kjo më ngacmon nervat. Të gjithë kanë uruar të ishin të parët, që bota të fillonte dhe të përfundonte me ta. Dhe kur kjo duket e pamundur, si t'ia bëjmë? Megjithëse nuk kanë guxim që ta thonë haptas, nuk janë pak ata që besojnë se femra duhet të rrijë mbyllur në shtëpi, si një zog në kafaz, në pritje dhe pa kontakt me botën dhe me njerëzit. Prandaj edhe ka gra që domosdoshmërisht gënjejnë secilin që e bën këtë pyetje, duke thënë se zotëria i dashur është vetëm mashkulli i dytë në jetën e tyre dhe se fjalët që dëgjon poshtë e lart nuk janë gjë tjetër pos shpifje.

Tjetër gjë që më irriton, është se shumë meshkuj e gjykojnë veten mbi të tjerët, se janë më të mirët, se vetëm ata janë të denjë dhe, kulmi i arrogancës, se janë kampionë të seksit. Mashtrojnë veten me iluzionin se askush nuk e bën atë punë më mirë se ata. A e di sa të tillë kam takuar unë? A e di sa të tillë ka vetëm në

lagjen time? Sa kampionë të seksit ka në këtë qytet. Këtu është liga e kampionëve!

Dhe shumë, pas seksit, me siguri pyesin: "A të pëlqeu?"

Si t'u thuash: Jo! Si t'u thuash se ka edhe më mirë? Si t'i thuash se u ndjeva e zhgënjyer, se mbaroi punë ende pa u nxehur unë? Si t'u thuash se gjithë ajo përpjekje nuk ishte në nivel me pritshmërinë? Është paksa mizore ta bësh një gjë të tillë. Nuk është e drejtë që kampionëve t'u thyhet iluzioni. Nuk është njerëzore t'u vjedhësh ëndrrat. Prandaj, sa herë që më ndodh të përballem me kampionë të tillë, e përmbledh veten, shpërfaq buzëqeshjen më të bukur dhe me plot gojë them: "Plako, e ke qa fare."

Për çdo gjë që nuk shkon, faji është i femrës. Meshkujt që kam njohur unë, kur një lidhje nuk ka shkuar mirë, e kanë pasur shumë të vështirë të pranojnë se ata nuk ishin të duhurit për mua. Ende nuk e kam takuar një mashkull që nuk është përpjekur të jetë organizator i ditëve të mia. Madje ka edhe të tillë që kanë ambicie të jenë censurues të ëndrrave të mia. Nëse jam e lidhur me dikë, nuk do të thotë se jam pronë e tij dhe se do të më duhet të jetoj ashtu si thotë ai. Pres atë mashkull që do ta pranojë se unë jam skenariste dhe regjisore e jetës sime, që do të jetë i kënaqur që ka fituar një rol kryesor në jetën time.

Ti më thua se je i tillë dhe se nuk kam nevojë të pres më tutje.

Nuk e di. Mbase edhe mund të jesh, por të gjithë në fillim shiten si engjëj.

Ti më thua se ndihesh i fyer nga këto fjalë.

Edhe ky reagim yti është diçka tipike nga bota e mashkullit shqiptar. Kjo më jep rastin të flas më tepër rreth elementit fëmijëror brenda personalitetit të shumë meshkujve.

Kur partnerët e mi më ngacmonin, me vend e pa vend dhe me shije e pa shije, gjithnjë justifikoheshin duke thënë se po bënin shaka. Ndërsa kur unë i ngacmoja ata, qoftë edhe vetëm pak, shpesh edhe pa qëllim, ata menjëherë tërhiqeshin dhe ankoheshin se po i ofendoja. Njësoj si ata fëmijët e vegjël që, kur ua ndalon një veprim, menjëherë ia plasin vajit. Fëmijët duan që t'i mbledhin të gjitha lodrat e mundshme përreth vetes, pavarësisht a do të luajnë me to apo jo. Ata janë të bindur se lodrat u takojnë natyrshëm. Kështu janë edhe meshkujt. Përballë një femre sfiduese, kërkojnë me çdo kusht gjithë kujdesin dhe gjithë vëmendjen e nevojshme për ta ushqyer egon e tyre. Nuk e kuptojnë se kujdesin dhe vëmendjen e kanë marrë pa kushte dhe se edhe ata duhet të bëjnë njësoj.

Gjëja e fundit që patjetër duhet të them, është se shumë meshkuj janë qyqarë. Nuk janë në gjendje të ballafaqohen dhe të thonë vërtet pse duan të ndahen. Por, në vend të kësaj, shpikin disa detyrime të pavërteta, nuk përgjigjen në telefon dhe as mesazheve. Qëllimisht dhe pa pikë nevojë e krijojnë ankthin e paqartësisë, madje edhe për periudha tmerrësisht të gjata, pa fije ndjenje përgjegjësie se me veprimet e veta janë duke shkaktuar agoni te tjetra. Zotëria vendos që një ditë të silllet si i huaj i cili do të të shmangë me çdo kusht. Njësoj si ata fëmijët që kur bëjnë një sherr në shkollë, sajojnë lloj-lloj justifikimesh vetëm që t'i shmangen përgjegjësisë.

Natyra fëmijërore e këtyre meshkujve vërehet edhe më shumë pas ndarjes. Kur dëgjojnë se një ish e dashura e tyre e

ka rimarrë veten dhe ka mundësi të lidhet me dikë tjetër, ata zakonisht do të bëjnë çmos për ta rifituar atë. Jo se vërtet e duan, por si fëmijë të rritur që janë, nuk duan që dikush tjetër të luajë me lodrën e tyre, sado e parëndësishme të jetë ajo për ata.

Ti pohon se të gjitha këto janë të vërteta, por thua se jo të gjithë janë njësoj.

Këtë e besoj edhe unë. Jam e bindur se ka meshkuj që janë e kundërta e këtyre që përshkrova. Unë besoj në të mirën që fshihet brenda njeriut, besoj se një ide e mirë që lexohet diku, ka fuqi ta ndryshojë botën, prandaj edhe jam ulur e po i shkruaj këto radhë.

NJË FJALI E VETME

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Meshkujt shqiptarë!

T'i duash deri në urrejtje.

Dhe më pas, në vorbullën e inatit dhe të zhgënjimit, ta bindësh veten se mund t'i dashurosh përsëri.

FAJTORE PËR HESHTJEN E TYRE

(shënim i Zonjës Z)

Nëse të jam dukur kritike ndaj një lloj mashkulli shqiptar, të jesh i bindur se dy herë më shumë jam kritike ndaj një lloj femre shqiptare.

Femrat jo vetëm duhet të ankohen për padrejtësitë që iu bëhen, por duhet të gjejnë guximin që të marrin fatin e vet në duart e tyre. Shumica e femrave shqiptare nuk e ngrenë kurrë kokën dhe kjo është më e keqja. Kur ndonjëra prej tyre tregohet e guximshme dhe synon të jetojë ashtu siç ajo e vlerëson, janë vetë simotrat e saj që nguten ta gjykojnë, ta përflasin dhe ta luftojnë.

Fjala "kurvë", "lavire" e të tjera si këto, së pari përdoren nga vetë këto gra, saqë duket sikur ato nguten të luajnë rolin edhe të shenjtores, edhe të denoncueses. Mendojnë se kështu do të fitojnë një vlerë të shtuar dhe më kujtojnë skllëverit që u bëheshin krahë padronëve në disiplinimin e skllëverve të tjerë. Është interesante si të robëruarit tërë kohën flasin për lirinë, por, në të njëjtën kohë, tremben prej saj. Për shumicën prej tyre, liria është një aventurë e rrezikshme me plot sfida, të papritura dhe rreziqe të panjohura, sepse në liri ata duhet të kujdesen për veten e tyre. Ndërkaq, sado e keqe të jetë, me robërinë janë mësuar dhe dinë çfarë të presin prej saj. Kështu janë edhe këto

lloj femrash, robëresha të një sistemi të cilin janë të parat që e mbrojnë me çdo kusht. E kam shumë të rëndë të vazhdoj të flas më shumë për këtë.

VIKTIMA TË RREJSHME

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Nuk më pëlqejnë ato femra që luajnë rolin e viktimës. Më irriton ajo femër që tërë kohën përpiket që mashkullin e saj ta lodhë me ndjenjën e fajit, në mënyrë që ai të ndiejë keqardhje pse ajo nuk del, pse ajo nuk punon, pse ajo mërzhitet e të tjera si këto. Fajësojnë meshkujt për çdo gjë që ato nuk mund të bëjnë vetë. Jam shumë e bindur se ato gjejnë diçka që i pengon edhe gjatë seksit. Më duket sikur i shoh burrat duke gufuar nga pasioni, ndërsa ato, në vend që të flakin tutje të gjitha komplekset dhe maskat, fillojnë të mbajnë leksione e të shpërndajnë ankesa.

saqë nga kënaqësia të ligëshrohen edhe gjunjët. Këtë ndjesi unë e kam pasur që në takimin e parë me Z-në dhe vazhdoj ta kem ende.

BUKURIA E FSHEHTË

Mendjelehtat nxitojnë të tërheqin vëmendje, ndërkaq, një zonjë e vërtetë kërkon vetëm respekt. Nuk kërkon rrotullime kokash, se thjeshtësia e saj natyrshëm bie në sy. Kjo është Z-ja. Pak e shkujdesur, sepse nuk beson në rregulla. Një grua e lindur për të jetuar gjallërinë e jetës dhe për të vallëzuar me notat e muzikës së shpirtit, sekretin e së cilës e dinin vetëm mjeshtërit e vjetër. E dashuruar me lirinë e vet. Dhe do të bëjë gjithçka në mbrojtje të saj, sepse ajo e di, më shumë se kushdo tjetër, se bukuria ushqehet nga liria. Në çdo hap që hedh, ndihet magjia e bukurisë së fshehtë, bukurisë së vërtetë të një femre që nuk mund të përmblihet me sy. Kjo është pjesa e paarritshme e ekstazës që nuk mund të përjetohet në shpërthime epsesh. Aroma që të çorienton të gjitha shqisat, sharmi që ta deh shpirtin dhe epsndjellja që ta luan tepelekun e kokës. As edhe orgazmat e njëpasnjëshme nuk i afrohen dot kësaj ndjesie.

Pikërisht kjo bukuri e fshehur e bën një femër të jetë femër e vlerësuar dhe jo vetëm një objekt gjahu. Të jetë diçka më shumë, mëlmesa magjike me të cilën gatuhet nuri i bukurisë. Ndoshta, për ata që përtojnë ta lodhin mendjen me një koncept të ri, të gjitha këto janë dërdëllitje koti, sepse në sytë e tyre bukuria është vetëm imazh. Por duhet të kesh më shumë se sy për të parë bukurinë e fshehur. Të duhet ajo gjëja e ngrohtë që të digjet në qendër të gjoksit me flakë të butë dhe të këndshme,

AGIMI

(mesazh për Zonjën Z)

Zgjohem ende pa aguar.

Dhe ngutem që shkëlqimin tënd ta kërkoj në rrezen e parë të diellit.

E di se do të jesh aty, sepse edhe ti beson në mrekulli.

Në mrekullinë e jetës që shpërthen nga flaka e pastër e dashurisë.

Në atë që edhe atëherë kur na godasin e qëllimshëm na lëndojnë, na fuqizon të dyve dhe nuk na lë të shembemi.

Ngutem të zë agimin.

Nuk dyshoj.

E di se je aty.

E di se edhe sot je duke u lutur për forcë që të mund të mbrohesh nga kjo botë.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Unë: Femrat që unë kam njohur, më kanë gënjyer, me dhe pa arsye.

Zonja Z: Të gjithë gënjejmë. Dikush më shumë e dikush më pak, por të gjithë gënjejmë.

Unë: Meshkujt gënjejnë më pak se femrat.

Zonja Z: Më vjen të qesh me këtë teori tënden. Flas nga përvoja: të rrallë janë ata meshkuj që nuk gënjejnë. Jam e bindur se përqindja e tyre është aq e vogël, saqë, në raport me shumicën, në pikëpamje matematikore, paraqesin vetëm një gabim statistikor dhe jo një fakt shkencor.

Unë: E ke gabim. Ka meshkuj që janë të sinqertë dhe besnikë.

Zonja Z: Po, siç ka edhe femra të sinqerta e besnike. Historitë e femrave nuk dallojnë shumë nga historitë e meshkujve.

KURESHTJA E PAVEND

Ne meshkujr kemi kureshtje të pafund që të bëjmë pyetje për çdo gjë: për gjëra nga e shkuara dhe e tashmja, për mendime, dëshira dhe ëndrra të një femre. Më pas, nuk mund t'i përballojmë përgjigjet. Pavarësisht asaj çka deklarojmë se jemi mendjehapur dhe të mirëkuptueshëm, se e duam ashtu siç ajo është, më të gjitha të mirat dhe të këqijat, në të vërtetë, duam të dëgjojmë vetëm ato përgjigje që na përshtaten.

Disa nga miqtë e mi më pyesnin shpesh se si i përballoja takimet me ndonjë nga ish të dashurit e saj, sipas tyre, kjo duhej të ishte shumë e sikletshme. Disa të tjerë më thoshin se nuk mund ta imagjinonin veten përkrah një femre që kishte shkuar me shumë meshkuj. Të dyja këto çështje më bënë të qeshja, pasi nuk e kuptoja logjikën e tyre.

Pse duhej të turbullohesha përballë ndonjë ish të dashuri? Vetë fjala "ish" nënkuptonte të gjitha arsyet pse kjo çështje nuk do të duhej të më prishte punë. Ndërkaq, çështja e dytë ishte aq e kotë, sa nuk e meritonte as të komentohej. Sipas meje, vetëm dikush që nuk është i sigurt në ndjenjat e veta, gjen kohë e vullnet të merret me fantazma nga e shkuara. Ai që dashuron vërtet, jeton në të tashmen dhe i gëzohet së ardhmes.

PAFAJËSIA E GËNJESHTRËS

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Një femër ka fuqi të mbyllë kapitullin e një historie të pakëndshme, ka fuqi të dëgjojë një përgjigje që nuk i pëlqen dhe të mos e hapë më atë temë. Nuk e di nëse e njëjta mund të thuhet edhe për ju, pasi në imagjinatën tuaj, po ju vetë krijoni fantazma, prej të cilave më pas nuk mund të liroheni. Përballë një realiteti të tillë, një femër nuk ka zgjidhje tjetër, pos që të tregohet e kujdesshme dhe disa gjëra t'i kalojë në heshtje. Ashtu siç kam bërë sa herë edhe unë. Megjithatë nuk kam hequr dorë nga ëndrra që një ditë të takoj një mashkull me të cilin mund të flas lirshëm për çdo gjë, pa u trembur se do të paragjykohej. Një mashkull me të cilin do të mund të ndaj si historitë edhe idetë e mia më të çmendura. Një mashkull me të cilin do të mund të jetoj e lirë.

KRENARIA E NJË FEMRE

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Disa herë më ke pyetur se si duhet të sillesh për të mos cenuar krenarinë e një femre.

Është e thjeshtë. Mos harro të shprehësh vlerësimin për çdo gjë që ajo merr përsipër. Ta dëgjosh deri në fund. Të marrësh parasysh mendimin e saj. T'i falësh ngrohtësi e përkëdheli me po të njëjtin përkushtim që ajo të fal ty. Mirëkuptim për dashurinë që kultivon ndaj gjërave të bukura. Ta duash brishtësinë dhe delikatesën e saj. Dhe, mbi të gjitha, respekt për qenien e saj si individ, e më pas si grua.

ZHGËNJIMI ME VETEN

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Ti thua se femrat shqiptare janë të pavendosura. Sipas teje, kjo është një nga arsyet pse meshkujt shqiptarë ndihen superiorë dhe të domosdoshëm.

Është e vërtetë se ne e kemi shumë të vështirë të vendosim vetë për diçka dhe për këtë, në radhë të parë, jemi të zhgënjyera me veten tonë. Por, duhet ta pyesësh veten se pse femrat shqiptare janë kështu? Duam të jemi kështu apo e kemi humbur besimin se mund të jetojmë në një botë ndryshe? Ndoshta e gjithë kjo është rrjedhojë e zhgënjimeve tona të njëpasnjëshme, saqë pak prej nesh besojnë se, edhe nëse tregojnë vendosmëri, diçka do të ndryshojë. Duhet ta kuptosh se jo të gjitha janë si unë. Jo të gjitha pranojnë që të bëhen Z.

BRISHTËSIA

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Është shumë e lehtë ta thyesh zemrën e një femre. Merr pak pakujdesi dhe e përzien me doza harrese. Pret pak që këto dyja të shkrihen me njëra-tjetrën dhe më pas, në vend të tharmit, i shton pak arrogancë. Aty-këtu, i hedh sipër ndonjë fjalë të pamenduar, ndonjë flirt apo shikim provokues me dikë tjetër. Dhe të gjithën e vulos me bërtitje, të përzgjedhura me kujdes nga arsenali: "Sulmi është mbrojtja më e mirë". Nuk duhet asgjë më shumë. Gjëra të imëta, por të vrazhda e therëse, sepse një zemër e dashuruar është e brishtë. E bukur dhe e brishtë. Nuk mund të jetë ndryshe, sepse vetëm një e tillë mund të dashurojë çmendurisht dhe pa hile.

TRADHTIA

(shënim i Zonjës Z)

Nuk mund të jap një përgjigje universale pse femrat tradhtojnë. Mbase ti mund të më tregosh pse meshkujt tradhtojnë? E bëjnë nga nevoja apo nga arroganca? E bëjnë pse janë të pakënaqur apo e bëjnë ngaqë duan të provojnë sa më shumë femra, në mënyrë që më pas të krekosen para miqve?

Ti hesht dhe, në vend të më përgjigjesh, më pyet nëse kam tradhtuar unë ndonjëherë.

Po!

E kam bërë qoftë nga inati, qoftë si hakmarrje kur i kam zënë duke më tradhtuar. Por ka pasur raste kur thjesht nuk jam ndier e përmbushur dhe kam kërkuar diçka më shumë.

A pendohem për këtë?

Jo!

Por, në të njëjtën kohë, nuk e konsideroj se kam fituar ndonjë gjë të madhe me këtë punë. Paradoksi është se edhe në këto situata më kanë parë si pronë. Nuk ndiheshin keq, pse ata vetë kishin tradhtuar më parë apo pse më kishin neglizhuar dhe nuk kishin treguar kujdes të mjaftueshëm për nevojat e mia,

por zotërinjtë ndiheshin keq pse dikush tjetër më kishte prekur. Vetë mund të bëjnë çfarë të dëshirojnë, por të tjerët nuk e kanë këtë të drejtë.

Më e udhës është që problemin ta shtrojmë ndryshe: të të tregoj përse më ka ndodhur që të humb interesimin për një mashkull, edhe pse ishim në lidhje për një kohë të gjatë.

Me kohën kam kuptuar se në një lidhje janë dy pika vendimtare të kthesës që e diktojnë gjallërinë dhe zbehjen e saj. E para kur ndieja se të dashurit tim mund t'ia thosha të gjitha. E dyta kur e ndieja se nuk kishim më çfarë t'i thoshim njëri-tjetrit. Kjo e fundit rëndom ndodhte për shkak se, pasi çimentohej lidhja, më merrnin për të mirëqenë. E humbnin përkushtimin, nuk ndienin nevojë të më thoshin më fjalë të bukura, të ma bënin me dije se edhe më tutje isha e adhurueshme dhe e dëshirueshme. I neglizhonin po të njëjtat gjëra që ishin bërë shkak që të dashurohesha.

Pos kësaj, ajo çka më së shumti më ka zhgënjyer, është hipokrizia që e kanë shprehur me kalimin e kohës. Në fillim më thoshin se më donin për shpirtin tim rebel, për çmendurinë time, për mënyrën se si e shihja botën dhe më pas turreshin që të më kufizonin në po të njëjtat gjëra. Më privonin nga e drejta që të jem vetja, aq sa ndieja se zemra po më rrihte mes gërmadhash të ëndrrave të mia. Kështu natyrisht e humbja pasionin dhe rebelohesha, pasi prekesha në nervat më të ndjeshëm, në ata që shkojnë drejt e në zemër.

NEVOJA PËR DASHURI

Nuk dua që edhe unë të them se një femër është si një lule që ka nevojë për kujdes të vazhdueshëm. Kjo është bërë klishe, por më së miri e shpreh të vërtetën.

Z-ja më ka bërë të vetëdijshëm se gjendja emocionale e një femre ndikon edhe në nuancat e bukurisë së saj. Bukuria e vërtetë e një femre shpërthen në shkëlqim të plotë vetëm atëherë kur ajo jep dhe merr dashuri. Theksi është te harmonia e të dyjave, sepse, atëherë kur vetëm jep dhe nuk merr asgjë në kthim, një femër duket e lodhur dhe e trishtuar. Ndërkaq kur merr dhe nuk jep dashuri, ajo duket komike – shihni ato që enden poshtë e lart nën përkujdesjen e sponsorëve të pasur që duken si kukulla të ngrira në grim, thua se çdo çast mund të thyhen.

Një femër ka nevojë të ndihet tërë kohën e dëshiruar nga tjetri dhe të besojë se ajo është e vetmja. Dorën në zemër, kjo “e vetmja” është pak problematike, sepse ne secilës i themi “ti je e vetmja”. Por çfarë ka të keqe nëse besojnë në një gënjeshtër të bukur? Kjo nuk do të thotë se ato nuk dinë ta dallojnë kur ne i gënjejmë. Bota nuk mund të bëhet më e mirë nëse nuk flasim, nuk e shprehim dhe, mbi të gjitha, nëse nuk e jetojmë dashurinë.

Pasioni i një femre duhet të ushqehet me gjëra të reja, me shkëndija që ia rindezin imagjinatën dhe pse jo edhe me

eksperimente të reja në shtrat. Në fillimet e një lidhjeje, jeta erotike është një tablo me ngjyra të zjarrta dhe më pas, me kalimin e kohës, kthehet në një tablo me disa shkarravina të lodhura. Të shumtën e kohës, kjo ndodh për fajin tonë, pasi nuk e vrasim mendjen se kohë pas kohe duhet t'i vardisemi njësoj si të ishim në fillim të lidhjes e ta inkurajojmë që të bëjmë gjëra jo të rëndomta. Të bëjmë me të dashuri në ashensor, në makinë, të shkojmë në hotel, si të ishim një çift i fshehtë dhe shumëçka tjetër.

Sikur këto fjalë që po shkruaj tani, të kishin zë, atëherë do të më dëgjoje duke ulëritur: Një femër ka nevojë jetike për dashuri dhe pasion!

JETA BRENDË VETES

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Jam ëndërrimtare, sepse jam femër. Dhe një femër beson në thelbin e ekzistencës së kësaj bote, beson në mrekullinë e jetës. Jam e bindur se kjo është arsyeja pse durimi për ta siguruar vazhdimësinë e jetës i është besuar asaj. Nuk mund të besosh në mrekullinë e jetës, pa e ndier këtë mrekulli brenda vetes, pa ndier se si jeta krijohet brenda teje.

Sa herë që ua them miqve të mi, apo burrave që kanë kaluar në jetën time, ata xhindosen dhe si mburravecë fëmijërorë më japin leksione për rëndësinë e farës që japin. Është për të qeshur si meshkujt verbërisht besojnë në shenjtërinë e spermës së tyre. Nuk i kundërshtoj. I lë në iluzionin e tyre.

EDHE NE MUNDEMI

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Jo pak meshkuj shqiptarë besojnë se femrat shqiptare janë inferiore në raport me të huajat, sepse këto të fundit, sipas tyre, janë mendjehapura, të suksesshme dhe pallavra të tjera.

Pak rëndësi ka nëse femra është shqiptare, gjermane, turke, arabe, amerikane apo kushedi çfarë. Të gjitha femrat frymojnë njësoj, të gjitha mund të ndihen të bukura dhe mund të jenë të suksesshme. Dallimi qëndron te mënyra si shihen dhe si vlerësohen nga meshkujt, pasi duam apo nuk duam ta pranojmë, jetojmë në një botë meshkujsh. *It's a man's world* s'është thjesht një këngë e bukur. Nëse ti apo kushdo tjetër që lexon këto shënime, dëshiron që femrat shqiptare të jenë edhe më të bukura, edhe më të mençura, edhe më të zonjat, dije se nuk duhet ndonjë mrekulli e madhe. Trajtonani ashtu si do të dëshironit që dikush tjetër t'ju trajtonte ju. Kaq! Nuk duhet asgjë më shumë, të tjerat i bëjmë vetë.

MË DASHURO

(mesazh për Zonjën Z)

Më dashuro!

Edhe atëherë kur nuk di të dua as veten.

Edhe kur hutohem e pa dashje të lëndo.

Edhe atëherë kur të zhgënjej.

Pa ty jam vetëm një hije e ngrysur që e ka humbur besimin në fuqinë e jetës.

Më dashuro!

TË GJITHË JEMI TË NJËJTË

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

“Unë besoj në dashuri, por jam lënduar aq shpesh, saqë nuk besoj më te njerëzit. Kam filluar një rrugëtim të dhimbshëm nëpër të tatëpjetën e mosbesimit kronik, drejt stacionit të zyrtë të të ndjerit i zbrazët. Kështu është njeriu pa dashuri. Por më mirë të ndihem i zbrazët, sesa i lënduar!” – më tha sot një miku im. Një djalë i kujdesshëm, i pashëm, por mbi të gjitha një shpirt i pastër njeriu që nuk e meriton të ndiejë dhimbje, aq më pak dhimbje dashurie.

Vërtet ishte i prekur, kjo gjë ndihej madje edhe në çdo atom të hapësirës rreth tij. Ai më tregonte për ndjenjën e tij të zhgënjimit, e unë kisha ndjenjën se po ia dëgjoja mendimet që gumëzhinin në heshtje brenda shpirtit të trazuar, mendime të cilat ai ngurronte t’i ndante me mua: “Thonë se të dashurojnë, thonë se do të bëjnë gjithçka për ty, thonë se nuk duan gjë tjetër veç të të bëjnë të lumtur. Më pas fjalët i merr era. Sikur e tëra të ishte vetëm një shaka e rastit, një batutë sa për të kaluar kohën, një parodi që të qeshurat i ngurtëson në lot të akullt.”

Ti më pyete pse ta tregova këtë histori.

Ta kam thënë sa herë: historitë e femrave nuk dallojnë shumë nga historitë e meshkujve. Pavarësisht se çfarë themi, në fund të gjithë jemi të njëjtë: Qenie egoiste!

Një femër e lënduar mund të ketë dëshirë që meshkujt t’i paraqesë si qenie të ftohta, mizore dhe që janë në gjendje të të lëndojnë pa asnjë fije konsiderate, por kjo nuk është e vërteta e plotë. Edhe femrat dinë të jenë të pamëshirshme, të sillen me shpërfillje dhe ta poshtërojnë një mashkull që i dashuron sinqerisht. Miku im është ndër të rrallët që nuk ngurron t’i shprehë ndjenjat e vërteta, por zakonisht meshkujt shqiptarë nuk flasin për sikletet e tyre të zemrës, sepse jetojnë me bindjen idiote se, nëse ankohen për dhimbjet e zemrës, atëherë do të duken më pak meshkuj. Harrojnë se ndjenja e lëndimit dhe e zhgënjimit nuk kursen askënd dhe se guximi për t’i ndarë sikletet e zemrës me dikë tjetër i afron njerëzit.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Zonja Z: Si shkruhet për dashurinë?

Unë: Nga një lot për çdo presje dhe pikë, një ëndërr për çdo shkronjë dhe nga një kujtim për çdo fjalë. Të gjitha të shkruara me gjuhën e pafjalë të shpirtit.

Zonja Z: Vetëm kaq?!

Unë: Po. Dhimbja në gjoks nxjerr vargje që edhe i vdekuri mund t'i këndojë.

E BUKURA DHE BISHA

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Unë dashurinë e përjetoj si një bukuri që më bën të vendos tri pika kudo. Ajo më fal durimin të zbuloj të bukurën edhe aty ku askush tjetër nuk e ndien atë. Dashuria është një bukuri e pafjalë, e fshehur nga sytë e botës. Besoj në të dhe në emër të saj jam në gjendje të bëj edhe gjërat më të çmendura.

E ke pyetur ndonjëherë veten pse ajo përralla e famshme quhet "E bukura dhe bisha" dhe jo "Bisha dhe bukuroshi"? Të rrallë janë ata meshkuj që do të mund të më dashuronin nëse do të dukeshin si bishë. Aq të rrallë, saqë një gjë e tillë është pothuajse e pamundur.

brenda meje. Pavarësisht se një ditë do të plakem, do të tkurrem e do të tretim, përkrah një zonje të tillë do të ndihesha i ri.

ÇFARË IA MERR FRYMËN NJË MASHKULLI?

Bukuria?

Një mashkull mund të tërhiqet drejt bukurisë, por bukuria nuk mjafton. Ka aq shumë kukulla të bukura, secila më plastike se tjetra, që parakalojnë bulevardëve si në sfilatat e sezonit. Të bukura për t'u parë, por të hidhura dhe të tharta për t'u shijuar.

Mençuria?

Një mashkull gjithnjë do të sfidohet nga një femër e mençur, por as mençuria nuk mjafton. Ka aq shumë statuja kohësh moderne që, kur është fjala për punë të botës, dinë të analizojnë edhe detajet më të vogla, ndërsa kur përballen me sfidat e jetesës në çift stepen dhe nuk dinë nga t'ia fillojnë. Frymëzuese nga larg, por të ngurta dhe të ftohta për ta ndarë më të bukurën e shpirtit me to.

Çfarë atëherë? Çfarë ia merr frymën një mashkulli?

Shpirti i burë dhe përherë i freskët i një zonje të vërtetë, që ndihet dhe jo domosdoshmërisht shihet. Një urtësi e thellë që asnjëherë nuk imponohet. Një mirëkuptim që duam ta ndiejmë te miku ynë më i mirë. Një buzëqeshje mikluese që ndjell afri të pakushtëzuar dhe që vetvetiu ngacmon shpërthime pasioni. Një entuziazëm që përherë zbulohet nga fillimi dhe që asnjëherë nuk është i njëjtë. Vetëm një zonjë e tillë ta merr frymën. Vetëm një si Z-ja që nuk ngurron t'i japë krahë djaloshit rebel që fshihet

PRIMA BALERINA

(mesazh për Zonjën Z)

Mos prit nga unë të të them që je e bukur, siç bëjnë gjithë të tjerët. Ata që edhe sikur të sfiliten, nuk mund të shohin përtej asaj që u kapin sytë.

Bukuria është vetëm një çast, një imazh që fiksohet në mendje. Më pas çasti kalon. Harrohet. Si shumë imazhe të tjera që janë tretur nën gërryerjen e heshtur të kohës, asaj tinëzares dinake që nuk kursen askënd.

Ndërsa unë të dua përgjithmonë. Të të gjerb, ngadalë dhe ëmbël, si kafën e ngrohtë herët buzë ligenit. E më pas, të humb rrugën në kopshtin tënd dhe symbyllur të kërkoj orkidenë e egër. Të bukurën e brishtë, aroma e së cilës të deh edhe nga larg. Dhe aty të të pres në ankth, nëse do të jem i përzgjedhuri yt që të më fladitet shpirti në puhizën e dihatjeve tua.

Dua të jem matadori yt.

I pashpresë se do ta përballoj sfidën e radhës. Por i lumtur se mbi shpatën time do të thyhesh dhe ngjitesh përsëri, si një balerinë që vallëzon vetëm në cepin ku takohen lumturia dhe trishtimi.

SEKSI, GJUHA UNIVERSALE E NJERËZIMIT

(shënim i Zonjës Z)

Mbrëmë teksa po ndiqnim një debat televiziv mbi temën e seksit, të dyve na tërhoqi vëmendjen sjellja e panelistëve të cilët nuk flisnin në mënyrë të lirshme për seksin. Përdornin shumë metafora dhe elemente rrethanore, sikur t'u vinte turp dhe debati ndonjëherë bëhej komik. Ti u bërë aq nervoz nga mungesa e çiltërsisë, sa fike televizorin dhe më pyete se çfarë mendoja unë për këtë temë dhe për sjelljen e panelistëve.

Ndoshta prisje që si femër, të flisja ëmbël e butë dhe të shtiresha se kisha turp. Ndoshta ti prisje që edhe unë të thoja se seksi është diçka romantike dhe se domosdo lidhet me dashurinë. Jo! Këtë nuk do ta dëgjosh nga unë dhe, sado që mund të më shajnë dhe gjykojnë, e di se po them të vërtetën. Po atë të vërtetë që mendojnë të gjithë, por që shumica ngurron ta thotë.

Seksi nuk është romantik. Dhe asnjëherë nuk ka qenë i tillë.

Romantik mund të jetë takimi i parë. Romantike mund të jenë të gjitha ato lojërat dhe dredhitë e vogla e të mëdha që përdorim për ta joshur e magjepsur tjetrin. Diçka romantike, madje do të thosha shumë romantike, mund të jetë edhe paraloja, ajo shfaqja e vogël në fillim kur shtiremi se nuk

kemi ngut. Por vetë seksi – atëherë kur penisi penetron dhe fillon gara e dihatjeve, shtrëngimeve, gërvishtjeve, ulërimave, kafshimeve dhe gjithë atyre veprimeve të tjera që bëjmë dhe që për mirësjellje nuk do t'i përmend, nuk ka asgjë romantike. Përkundrazi, është e kundërta e çdo gjëje që ne e konsiderojmë romantike, sepse romanca është një ideal shpirtëror, ndërsa seksi është diçka rrënjësisht fizike dhe e domosdoshme. Seksi është diçka që të përçon një erëxim therës dhe mallëngjyes, por edhe magjepsës dhe joshës.

Kujdes fjalët që zgjodha!

Erëxim therës dhe mallëngjyes, diçka që prek rëndë në atë pëlhurën e hollë që lidh shpirtin me trupin. Kjo është edhe arsyeja pse e humbim logjikën kur na merr malli për seks dhe atje poshtë krijohen rrjetat e merimangës.

Erëxim magjepsës dhe joshës, diçka që të rrotullon tepelekun e kokës dhe, sado që të përpiqesh, nuk di e as nuk mund ta përmbash veten. Kjo është arsyeja pse nuk të rehatohet shpirti derisa nuk e ndien atë veglën brenda dhe në heshtje mendon: "Jepi! Mos prit, jepi!"

Një piktor do të thoshte se seksi është shkëlqimi i trëndafiltë, mëlmesa magjike që rifreskon një fytyrë të thartuar dhe të mërëzitur. Me siguri e ke dëgjuar atë reklamën që thotë: "Red Bull të bën me krahë!" Jam e bindur se autori i kësaj reklame, në të vërtetë, ka menduar: "Seksi të bën me krahë!" Ky shkëlqim i trëndafiltë të bën të flatrosh. Të bën të ndihesh e lehtë dhe e bukur si një flutur. Të ndiesh ekstazën e lirisë.

Ti më thua se nuk do të habiteshe nëse unë do të kisha një përkufizim timin për seksin.

Me tepër janë disa si tip proverbash. Nëse je fetar, seksi është dhuratë hyjnore. Nëse je ateist, seksi është pika kulmore e evolucionit natyror. Nëse je artist, seksi është harmonia e përkryer për të cilën ëndërronte Da Vinçi. Dhe nëse je biznesmen, seksi është një investim jetësor.

Ti qesh me fjalët e mia.

Më vjen mirë për këtë, sepse seksi është diçka e bukur dhe gjërat e bukura duhet të ta nxisin buzëqeshjen.

Cili është, sipas meje, dallimi mes një femre dhe një mashkulli, në pikëvështrimin e tyre rreth seksit? Gjatë seksit: çfarë synon një femër dhe çfarë synon një mashkull?

Çdo qenie njerëzore e përjeton seksin në mënyrën e vet unike. E megjithatë, nëse më duhet të përgjithësoj, do të thosha që femrat kërkojnë të bëhen shkencëtare në erotizëm: të zbulojnë, të studiojnë dhe të jetojnë çdo detaj të harmonisë ndërmjet shpirtit e trupit; ndërmjet ndjenjave dhe epshit. Ndërsa meshkujve, shpesh u mjafton të jenë ekspertë të pornologjisë. Madje ekspertë të pavarur, pasi testosteroni i bën të besojnë se ata nuk mund t'i përkasin një femre të vetme.

Ti përsëri qesh. Por edhe e di se po them të vërtetën.

METAFORA

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Në rrethin tonë edhe seksin e kuptojmë vetëm në ngjyra dhe metafora mashkullore. Nuk ka rëndësi kush e merr iniciativën, kush e udhëheq pasionin dhe e dikton ritmin, e vetmja gjë me rëndësi është se kush e fut veglën.

AROMA E SKANDALIT

Secili nga ne ka një botë të vetën të fshehtë. Një realitet intim të fshehur prapa maskave të përkorjes: për të ka nevojë shpirti ynë. Një pjesë imagjinare e parajsës, ku fshihemi sa herë që lodhemi nga të jetuarit. Ajo që për artistin është amshueshmëri e shprehur në një imazh të vetëm, për njeriun e thjeshtë është bota e tij e fshehtë, sepse vetëm aty mund ta jetojë të bukurën dhe të përtërihet.

Si magjistrice që është, Z-ja e di se e vetmja mënyrë për ta nxjerrë në pah këtë borë është të shohim përtej projeksioneve dhe maskave tona, sado të përkora qofshin ato. Një çelës që hap këto dyer të nënvetëdijes, është lënia e lirë e imagjinatës.

Z-ja jo vetëm që ta çliron fantazinë, por edhe ta tregon rrugën drejt guximit të domosdoshëm për ta jetësuar atë. Kushdo që ka provuar ta bëjë këtë, e di se kjo qasje na sprovon pikërisht me ato gjëra dhe situata prej të cilave jemi shmangur tërë jetën. Kësaj i thonë ta jetosh çmendurinë dhe të jesh i lumtur për këtë. Së paku për aq kohë sa zgjat, sepse asgjë e bukur nuk zgjat përgjithmonë.

“Skandali është një parfum që ta nxit imagjinatën dhe ta gjallëron shpirtin”, – është formula e Z-së. Kush nuk e kupton këtë, le ta bëjë krahasimin në mes të të bërit seks në një dhomë të errët ku nuk mund të të shohë askush, dhe të bërit seks në ashensor ku në çdo çast mund të futet dikush tjetër. Pa dyshim,

seksi në dhomën e errët është më komod, por ai në ashensor është ndryshe. Është epshor, i pisët, i ëmbël dhe në të njëjtën kohë, është edhe i trishtë, pasi kjo ndjesi e çmendur mund të përjetohet vetëm një herë.

SIMULIM ORGAZME

(shënim i Zonjës Z)

Dashnorët e mi kryesisht ishin të fiksuar pas orgazmës së tyre, duke neglizhuar pothuaj tërësisht timen. Nuk dua t'i fus të gjithë në një thes, por pak prej tyre e kanë ndier se nuk ishte e mjaftueshme vetëm që ajo vegla e tyre të futej brenda meje. Mendonin se përgatitja e tyre fizike ishte e mjaftueshme – disa ishin të bindur se të qenët atlet, nënkuptonte një dashnor të mirë. Dorën në zemër, të qenët atlet është një parakusht i rëndësishëm, por prapëseprapë është larg me të qenët i mjaftueshëm. Këta tipa, të dhënë pas atletizmit të tyre, e përjetonin veten si hamshorë të çmendur dhe mburreshin me këtë, duke menduar se do të më impresiononin. Nuk e shihja as të arsyeshme që t'ua shpjegoja se, për mua, një hamshor është dikush që nuk di të bëjë gjë tjetër, pos që të mbajë një ritëm të sforcuar, nuk dëgjon, nuk shikon anash dhe nuk e ka ndjesinë se është bashkë me dikë tjetër. Me tipa të tillë nuk kam përjetuar asnjëherë diçka më shumë sesa vetëm shfrytje fizike të epsheve.

Të rrallë ishin ata që e ndienin se për të përjetuar unë orgazmën, duhej që dashnori im të ishte i vetëdijshëm se ndjesitë e mia ishin po aq të rëndësishme sa edhe të tijat. Duhej që t'i ndiente drithërimat e mia, në mënyrë që të gjente atë pikën e

BOTA NUK MJAFTON

Shumë njerëz e përjetojnë botën si diçka të madhe, si një kaos të zhurmshëm dhe të frikshëm, si një kërcënim, prandaj vullnetshëm fshihen brenda guaskash imagjinare. Por Z-ja nuk është e tillë. Asaj bota nuk i mjafton. Ajo ndihet si një zog deti, krahëgjatë dhe e lindur ta sfidojë kaltërsinë e qiellit.

Z-ja është mishërim i guximit të fshehur në shpirtin e çdo femre. Një qenie e mbërthyer në zinxhirët e ndryshkur të provincialitetit. Një grua e lindur para kohës së vet, sepse bota shqiptare ende nuk është gati për vrullin dhe forcën e saj. Rrethi ku ajo jeton, pavarësisht përpjekjeve të saj, thjesht nuk e lë të jetë vetvetja. Z-ja e di këtë, prandaj edhe zgjedh të rrijë e vetmuar. Si një margaritar i çmuar në fund të oqeanit.

Të gjithë kemi nevojë që, së paku një herë në jetën tonë, të takojmë dikë si ajo. Dikë që i turbullon ujërat, jo për të trazuar mendjen, por për ta kthjelluar atë. Për të kuptuar nevojën se duhet sfiduar njëtrajtshmëria dhe, mbi të gjitha, për të respektuar dhe për të vlerësuar të bukurën.

KUR SEKSI NDËRHYN NË POLITIKË

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Politikanët e këtij vendi frustrimet e tyre në shtrat po i shprehin suksesshëm në politikë. Nëse nuk më beson, ndiq cilëndo mbledhje të Kuvendit të Republikës dhe do të shohësh se si asnjë nga përfaqësuesit nuk e dëgjon shoqi-shoqin, por të gjithë ulërijnë dhe shpërfillen. I trajtojnë rivalët politikë ashtu siç i trajtojnë dashnoret: në publik i injorojnë, ndërkaq larg syve të opinionit duhen me pasionin e atij që e mban epshin të fshehtë.

Por unë nuk do të mund të hesht kurrë ndaj atyre që ushqehen me dhimbjen dhe frikën tonë: kinse udhëheqësit tanë të nderuar. Janë ata që mjelin çdo gjë nga kjo bota jonë e vogël dhe e lodhur, ndërkaq veten e shohin si pjesë të një bote tjetër, thuajse ata vetëm aksidentalisht kanë lindur mes nesh. Për shkak të tyre edhe kemi ngelur prapa të tjerëve; shqiptarët janë një popull inteligjent, por fatkeqësia jonë është se udhëhiqemi nga po e njëjta kastë mediokrish që arrin të mbijetojë në të gjitha sistemet. Dhe janë këta mediokër që duan të na mbajnë të kurthuar në lojën e pafund të intrigave dhe mjerimit, sepse kështu, duke u grindur me njëri-tjetrin, nuk kemi kohë t'i demaskojmë për atë çka vërtet janë.

Shkenca ka përparuar dhe sot virgjëria mund të ribëhet. Personalisht nuk njoh askënd, por thuhet se moda e re është pikërisht kjo, rikthimi i virgjërisë. Ky është tregues tipik i ironisë së moralit sipërfaqësor: nuk ka rëndësi nëse vërtet je e virgjër, mjafton që të dukesh ashtu.

Nuk e di deri kur do të mbijetojë kjo mendësi. Kam përshtypjen se gjëra të tilla janë bërë boshti i traditave të rreme që jemi duke kultivuar si shoqëri. Në vend që këto tradita të zbehen, ato po bëhen edhe më të shpifura. Nuk e di deri kur shoqëria jonë do të vazhdojë të jetë rrethi i grave të tradhtuara dhe i burrave gënjeshtarë, rrethi i maturanëve virgjëresha të ndezura, mjeshtre të seksit, dhe i djemve, kinse të ndershëm, por me varësi nga pornografia.

Prandaj nuk dua t'ia di për moralin e botës, sepse nuk ka asgjë të ndershme dhe të drejtë në traditat e rreme. Do ta jetoj jetën time ashtu siç unë e vlerësoj më së miri dhe e di që edhe pse të gjithë do të më shajnë, në të vërtetë do të më kenë zili. Për mua, kjo është shtresa e fundit e ironisë së rrethit ku duhet të frymojmë.

STATUJAT MODERNE

(shënim i Zonjës Z)

Një ndër skemat më të shpifura që ka prodhuar morali sipërfaqësor është ajo e çiftëve që bëjnë të pamundurën që në publik të projektojnë imazhin e një çifti të lumtur. Mund t'i shohësh nëpër bare dhe restorante, të ulur përballë njëri-tjetrit si statuja të zymta, me shikime të humbura diku në një pikë, pa ndërruar as edhe një fjalë të vetme. Njësoj si të ishin dy të panjohur. A ka lumturi këtu?

Janë po këta që kur shkojnë në gosti, burrat luajnë rolin e partnerit serioz, por, në të njëjtën kohë, tinëz, vëmendjen e kanë të këngëtarët dhe beqarët e lira. Atëherë kur fiksojnë një femër që u pëlqen, do të bëjnë të pamundurën që t'i marrin numrin e telefonit. E nëse nuk mund t'ia marrin numrin, atëherë së paku emrin, në mënyrë që më pas ta gjejnë në *Facebook*. Në prapavijë të të gjithë kësaj, si të ishin të programuar për shumë funksione përnjëherë, nuk do të harrojnë që dashnoreve të veta, kohë pas kohe, t'u dërgojnë mesazhe ku u thonë se duan vetëm ato dhe se vetëm detyrimi po i mban në atë gosti.

Ndërkaq gratë, pasi përfundojnë ciklin e përsëritjeve dhe urimeve, nguten të shkojnë në tualet që të bëjnë një *selfie* dhe t'ua dërgojnë atë dashnoreve. Nënteksti është i qartë: Kur po takohemi? Të shkretat, mezi e presin takimin e radhës ku do

të mund t'i bëjnë të gjitha ato që nuk bëjnë dot me burrat e tyre. Këtë transformim, nga shenjtorja e shtëpisë te kurtizania e harbuar, do ta kishte lakmi çdo aktore. E gjitha kjo thjesht nuk mund të aktrohet, sepse është art i përjetimit, i gatuar në heshtjen e zjarrit të dinakërisë, një dinakëri e përsosur deri në detajet më të imta. Dinakëri në raport me njëri-tjetrit, por edhe në raport me rrethin. Ky është thelbi që i përkufizon këto statuja moderne që na zënë frymën, duke dashur të na bindin sa të lumtura janë.

Çfarë ndodh me jetën në çift kur partnerët nuk kanë më çfarë t'i thonë njëri-tjetrit?

Ndodh jeta. Ajo me të gjitha të papriturat e veta, pa përkëdheli. Ajo nuk do t'ia dijë për idetë tona mbi lumturinë dhe as nuk na i fal ato budallallëqet e vogla që ne mendojmë se kemi të drejtë t'i bëjmë çdo ditë. Të gjitha ato komplekse që ushqejnë si meshkujt, ashtu edhe femrat, me kohën bëhen më të rëndësishme se dashuria që fillimisht i ka bashkuar, dhe me të rëndësishme se edhe vetë njëri-tjetri.

Jeta në çift është e kundërta e asaj çka ne mendojmë se duhet të jetë. Shumica janë të papërgatitur për përgjegjësitë që nënkuptohen ndaj njëri-tjetrit dhe për kompromiset e vogla e të domosdoshme që duhen bërë. Në vend të kësaj, më shumë jepemi pas projeksionit tonë mbi tjetrit dhe jo pas asaj që tjetri realisht është.

Dy vetë mund të jenë bashkë për një kohë të gjatë, por, përderisa ngulmojnë të shohin vetëm atë që duan, atëherë do të vazhdojnë të ngelin të panjohur për njëri-tjetrit. Kjo i hap rrugë zhgënjimit të pafjalë, heshtjes që mbyl çdo përpjekje për bisedë.

Çiftet zënë një hapësirë fizike diku, në dukje janë së bashku, ndërsa në të vërtetë janë shumë të largët. Në restorantet, *pub*-et dhe familjet tona ka aq shumë statuja të kohërave moderne, fytyra të ngrysura, buzëqeshje të ngrira, shikime të humbura, përherë të angazhuar se kush më shpejt do ta vrasë kohën.

A do të bëhemi edhe ne të tillë?

Në çastin kur edhe ne do të fillojmë të shihemi me sytë e botës, atëherë do të bëhemi të tillë. Por të jesh i sigurt se unë nuk do të lejoj që ndonjëherë të mbërrijmë deri në atë pikë. Unë kam aq krenari sa, kur ta ndiej se diçka serioze nuk po funksionon, t'i largoj nga jeta ime të gjitha ata që nuk më vlerësojnë për atë çka jam vërtet.

ILUZIONI

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Për shkak të moralit sipërfaqësor të shoqërisë sonë shqiptare, martesë nga një institucion që, sa për sy e faqe, të gjithë e zënë në gojë, po kthehet në një iluzion dhe dekor. Jo pak nga meshkujt e fuqishëm, qoftë të politikës, biznesit apo të artit, edhe pse martohen, vazhdojnë të shkojnë me femra të tjera. Në publik, tërë kohën luajnë rolin e burrit besnik, ndërkaq gratë e tyre, edhe pse e dinë të vërtetën, janë të kënaqura, sepse së paku në pamje të jashtme gjërat duken në rregull.

Për më tepër, këta burra që luajnë rolin e bashkëshortit ideal, pas një kohe shtëpinë e kthejnë në një bazë të sigurt, vetëm për gjumë dhe për t'u ushqyer. Disa nga këta meshkuj nuk mund të bëjnë seks me gratë e veta, mbase për shkak se ajo është përherë në shtëpi dhe nuk paraqet kurrfarë sfide. Të vetmet aktivitete që mund ta bëjnë me to janë: sa herë që vjen koha për furnizime të frekuentojnë hipermarketet, të paraqiten së bashku në vizita familjare, dasma dhe funeralë.

Kaq!

Po të njëjtët, bëhen dashnorë ëndrrash, të kujdesshëm, të zjarrtë dhe përherë të gatshëm për seks, kur kjo është pjesë e një aventure apo e diçkaje të ndaluar për ta.

Nuk dua të përgjithësoj, pasi edhe unë besoj se ka meshkuj që janë ndryshe, por të gjithë e dimë se gjërat janë pak a shumë kështu. Nuk dua të shkruaj hartim a të shes edhe unë moral për këtë dukuri të shpifur. Secili çift i di më së miri punët e veta dhe secila femër duhet të vlerësojë vetë se çfarë është dhe çfarë nuk është e pranueshme për të. Por, së paku le të na kursejnë nga gënjeshttrat e kinse lumturisë së tyre.

E ke vënë re se kur japin intervista të gjitha çiftet *VIP* thonë të njëjtën gjë: Ne jemi shumë të lumtur; ne kemi një marrëdhënie shumë të hapur; ne gjithnjë e mbështesim njëri-tjetrin... Të gjithë duan të tregohen të përsosur, çifti ideal. Më vjen për të vjellë! Sipas këtyre, në mesin tonë nuk ka asnjë çift normal: njerëz që zihen e duhen, i bërtasin njëri-tjetrit e pastaj, pasi pajtohen, bëjnë seks si për herë të parë.

TË ZGJEDHËSH PËR VETEN

Ajo kurrë nuk kishte pranuar ta kurthonte veten me dikë, vetëm e vetëm ngaqë e kishin parë bashkë me të dhe njerëzit mund ta përgojnin. Z-ja nuk bën pjesë në ato femra që e kanë ulur kokën para padrejtësive të rrethit tonë dhe besojnë se, të zgjedhësh për veten, është një luks. Ka shumë vajza të tilla që bëhen viktimë e një gabimi të rastit apo të një keqkuptimi të vogël dhe më pas detyrohen që ta kalojnë jetën me dikë që nuk i meriton. Por jo Z-ja. Ajo, pa u menduar dy herë, u ka treguar udhën meshkujve të rastit dhe gjuhëve të liga.

REBELIMI SEKSUAL

(shënim i Zonjës Z)

Dua të të tregoj historinë e asaj që mund të cilësohet si fillimi i rebelimit tim seksual. Pakkush mund ta besojë, por virgjërinë e kam humbur vonë, diku në vitin e dytë të fakultetit, me një djalë me të cilin njihesha që në gjimnaz. Qëndruam të lidhur rreth tre vjet, por në vitin e fundit fillova ta ndieja sikur e kisha vëlla. Thjesht nuk ndieja më asnjë lloj tërheqjeje. Ai vetë mjaftohej me një seks të shpejtë e përmbarimtar dhe as nuk kujtohej të merrej me mua. Nuk e ndiente se unë kisha nevoja përtej një marrëdhënieje bardhezi dhe se isha një natyrë që kërkonte të sfidohej me gjëra të reja. Ndoshta sillej kështu pasi ishte i ri dhe ende nuk kuptonte mirë as veten e tij, por mua më ishte sosur durimi dhe nuk mund të prisja në pafundësi që ai të piqej. Nuk mund ta vazhdoja jetën me dikë, për të cilin nuk ndieja më asnjë lloj tërheqjeje, vetëm e vetëm se familjet tona kishin krijuar disa ide për të ardhmen tonë dhe prisnin që ne të fejohehim. Kur i bisedoja këto me shoqet e mia, ato më etiketonin si të çmendur. Sipas tyre, nuk kishte fort rëndësi çfarë ndieja gjatë seksit, por kishte rëndësi të ruaja lidhjen me çdo kusht.

As familja dhe as shoqëria ime nuk donin të kuptonin se unë nuk mund ta imagjinoja veten si një femër që duhet vetëm të hapë këmbët dhe të jetë në shërbim të dëshirave të dikujt. Nëse

i dashuri im kishte nevojë për dikë që të zbrazte koqet, atëherë, për aq sa më interesonte mua, ai mund edhe të masturbohet. Nuk e kuptoja pse kënaqësia e tij duhej të vinte para sime.

Pavarësisht pritjeve të familjes sime dhe kritikave të shoqeve të mia, vendosa të ndahem. Në fillim kisha pak dilema, se mos ndoshta po ngutesha, por në çastin kur ia komunikova dyshimet e mia, kuptova se sa të drejtë kisha që po e braktisja. Ai as që ishte i vetëdijshëm se diçka po vlonte brenda meje, mendonte se gjithçka shkonte mirë mes nesh dhe as që e kishte ndier pakënaqësinë time. Për mua ky ishte kulmi. Ka gjasa që edhe sot e kësaj dite të më quajë të çmendur që prisha parajsën midis nesh.

Nëse historia me vëllanë tim ishte çasti kur isha liruar nga kthetirat e skemave që më impononte mendësia e nënës sime, pakujdesia dhe arroganca e të dashurit tim ishte çasti kur ndjeva se duhej të lirohesha nga kthetirat e skemave me të cilat jetonin shoqet e mia.

U rebelova dhe fillova një kapitull të ri. Doja ta eksploroja deri në fund seksualitetin tim dhe të zbuloja atë shkëlqimin e trëndafiltë që ndien një femër atëherë kur plotësohet seksualisht dhe shpirtërisht. Këtu filloi periudha më intensive e jetës sime, ku për disa u bëra një yll i paarrtshëm, për disa një ë përdalë e për disa të tjerë vetëm një e çmendur. Pakkush e kupton se jam vetëm një shpirt i rebeluar.

LISTA

(shënim i Zonjës Z)

Kur je vajzë të thonë:

Një vajzë e mbarë shoqërohet vetëm me një mashkull.

Një vajzë e mbarë kthehet në shtëpi para darke, pasi është turp nëse endet rrugëve më vonë.

Një vajzë e mbarë ka marrëdhënie seksuale vetëm me atë që do të martohet.

Një vajzë e mbarë nuk pi cigare.

Një vajzë e mbarë nuk bëhet "tapë" dhe nuk shoqërohet me ata që bëhen tapë e bëjnë marrëzira.

Një vajzë e mbarë!!!

Mos ndoshta është robot?

Pastaj kur të martohesh të bëjnë me dije:

Për një grua të martuar dhe të ndershme nuk është e hijshme të ketë shokë: shok ke burrin dhe s'ke nevojë për një tjetër. Po gabove e dole për kafë me një shok, menjëherë përhapen llafe.

Një grua e martuar dhe e ndershme nuk del vetëm, aq më pak natën ose të kthehet vonë në shtëpi. Për çdo të dalë duhet t'i marrësh leje burrit dhe të mos harrosh ta çekësh orën se kur do të kthehesh.

Një grua e martuar dhe e ndershme zbukurohet vetëm për burrin. Nëse e mban veten më tepër sesa duhet kur shkon në punë apo kur del, atëherë i bie që po zbukurohesh për ndonjë tjetër.

Një grua e martuar dhe e ndershme!!!

Mos ndoshta është e burgosur?

Ja kështu vazhdon të përpëlitet femra shqiptare. Ajo vazhdon të shihet si pronë e burrit që ka në duar fatin dhe jetën e saj. Ai e ka këtë fuqi shumë më parë se ta takojë atë. Për këtë ajo duhet të tregohet "vajzë e mbarë" dhe të qëndrojë në pritje të ardhjes së madhërisë së tij.

Unë nuk mund të duroj marrëzira të tilla, prandaj dhe kam refuzuar që të jem "vajzë e mbarë". As që mund të imagjinoj veten si një e martuar, përderisa ndershmëria shihet vetëm në këto filtra.

E di se për këtë shumëkush më sheh si të çmendur, por mua kjo nuk më bën më përshtypje.

"Më mirë e çmendur që jeton të vërtetën, sesa një kukull që dehet në gënjeshtër të bukura."

Më pëlqen shumë ky varg yti.

Kështu jam edhe unë.

PAKKUSH E DO TË VËRTETËN

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Diku më shumë e diku më pak, femra shqiptare vazhdon të shihet si një lloj prone. Madje edhe ato zonjat e veshura rëndë që sfilojnë nëpër kanale televizive, që pjesën më të madhe të kohës e kalojnë te parukierja dhe që na shesin mend për koncepte elitare, edhe ato, kohë pas kohe, hanë shuplaka e durojnë poshtërsi nga më të ndryshmet. Këtë të vërtetë pakkush do që ta dëgjojë, pasi ua rrënon atë imazh të rremë që shpërfaqin në publik. E kanë shumë gabim, sepse dikush që ngrë dorë njëherë, ngrë dorë edhe për herë të dytë. Një femër shqiptare mbase mund të falë shumëçka nga vargu i madh i padrejtësive që i bëhen, por jo dhunën ndaj saj, madje, edhe nëse kjo çon drejt ndarjes apo skandalit publik.

Një mikeshë e imja që vetë ka kaluar nëpër diçka të ngjashme, më ka treguar: "Sa herë që ngrinte dorë mbi mua, më pas pendohej. E shihja se pendimi i tij ishte i vërtetë, por kjo nuk e ndalonte që të bënte përsëri të njëjtën gjë."

Ndonjëherë mendoj se mënyra e vetme për t'u ikur këtyre përvojave poshtëruese është që vullnetshëm të zgjedhësh të

qëndrosh vetëm dhe të mos lidhesh me askënd. Por është shumë e vështirë të jesh e dashuruar dhe të vazhdosh të qëndrosh vetëm. Kjo është arsyeja pse në fund një femër shqiptare ul kokën dhe pranon përluljen. Ajo do të vazhdojë të dashurojë, por asgjë më kurrë nuk do të jetë e njëjtë.

FRIKA E VËRTETË

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Ne që nuk turpërohemi nga ndjesitë tona, ne nuk trembemi as nga skamja, as nga lufta, as nga kafshëria e jonjerëzve, por vetëm nga çasti kur nuk do të kemi dikë afër, me të cilin mund të ngushëllohem në përqaftim.

Të gjitha mund t'i bëj vetë. Mund të dal të endem rrugëve deri në mëngjes. Madje, vetë mund të përjetoj edhe orgazëm, pa pasur nevojë fare për një partner, besoj e di se gishti i mesëm ka shumë funksione dhe nuk përdoret vetëm që t'ia bësh më dije dikujt se duhet të pirdhet. Të gjitha, por nuk mund ta ngushëlloj veten time.

E urrej vetminë!

E urrej kur më del gjumi natën dhe ndiej se në errësirë zhurmon vetëm frymëmarrja ime. Por shpejt përmbliqem dhe kthehem në krahun tjetër: ky është çmimi i lirisë sime.

Më të lehtë e kam të ndihem e trishtuar, sesa ta ndiej veten pronë të dikujt. Ndoshta njeriu i duhur që unë e pres, mund të mos vijë kurrë. Mbase ky nuk je as ti, por unë do të vazhdoj të pres, sepse liria është e vetmja gjë që vërtet kam.

YLLI

(mesazh për Zonjën Z)

Ti je një yll në kërkim të qiellit.

Aty ku do të mund të shkëlqesh e qetë dhe e lirë prej trazimit të atyre që u prish punë drita jote.

Prandaj edhe sonte lutem që ky qiell të jem unë.

Ta dëshmoj se jam i denjë për dashurinë tënde.

VETVETJA

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Të jesh vetvetja, do të thotë të jesh ndryshe nga të tjerët. Secili nga ne është vetëm një në këtë botë.

Shpesh ndihem si një gladiator.

E vetmuar në një arenë të etur për gjak, në një duel të pafund, përballë intrigave oborrtare. Ndiej sa të egër janë njerëzit, aq sa më bëjnë të dyshoj: vallë, vërtet janë njerëz apo shtiren si të tillë?

(MOS)PRITJA

Dikur ëndërronte dhe priste.

Priste dikë që do ta dashuronte për çmendurinë e saj.

Dikë që do ta respektonte për UNIN e saj të veçantë që natyrshëm i frymonte brenda.

Dikë që lumturinë e saj do ta bashkëndiente deri në ekstazë, ndërsa mërzinë e saj deri në humnerë.

NJË KOKTEJ KOMPLEKSESH

(shënim i Zonjës Z)

Mbrëmë ti nuk fole.

Mendjen e kishe diku tjetër dhe doje që vetëm ta ndienim njëri-tjetrin në përfaqime. Ndërkohë që të mbaja shtrënguar, m'u duk rast i mirë që të të argëtoja pak me rrëfime për komplekset e kota që ushqejnë disa femra e meshkuj në Shqipëri.

Shumë meshkuj shqiptarë kompleksohen nga gërryerja që u bën troku i heshtur i viteve. Posa u afrohen të dyzetave, fillojnë të bëjnë të gjitha ato majmunllëqe që nuk i kanë bërë dot në gjimnaz: vrapojnë pas çdo femre, sikur të ishin edhe njëherë 20-vjeçarë. Mbajnë ligjërata mbi jetën, njësoj si ata tridhjetëvjeçarët që u duket vetja se i kanë kuptuar të gjitha të pathënat e kësaj bote dhe në të njëjtën kohë përpiqen të duken seriozë, aq sa u duhet të përngjajnë me moshën që vërtet kanë. Të gjitha këto petka i veshin përnjëherë dhe klithin se duan të jetojnë të lirë. Ironike kjo: të mbërthyer në komplekse, i thurin himne lirisë.

Nuk është se femrat janë më mirë.

Femra tipike shqiptare përjeton tri faza të rëndësishme në jetën e saj. Në gjimnaz, me çdo kusht, përpiqet të duket

më e pjekur – lexo e gatshme për çdo gjë. Posa të përfundojë studimet, nëse vazhdon të jetë e pamartuar, do të bëjë çmos që të tjerët ta ndiejnë si më të re. Ndërkaq, kur shfaqet një rast serioz për martesë, përnjëherë futet brenda personazhit të një zonje të rëndë, fjalëpakë dhe që gjërat i peshon mirë. E shkreta nuk ka faj, sepse vetëm në këtë rol mund t'ia mbushë mendjen pretendentit se ajo ofron sigurinë që ai kërkon. Këto femra besojnë se djemtë e pashëm vetvetiu do t'u afrohen dhe se ato vetëm duhet të mbajnë qëndrim të rëndë dhe të presin.

Me siguri të ka rastisur të shohësh disa femra në grup, në *pub* apo diskotekë, të gjitha të rreguluara, të veshura me modën e fundit dhe secila duke u përpjekur të duket më joshëse se tjetra. Edhe pse rrinë bashkë, secila prej tyre ëndërron që nga aty të dalë tinëz në shoqëri të dikujt që do t'i çajë gjunjët e tij duke u përpjekur të fitojë vëmendjen e saj. Pothuajse të gjitha dështojnë në këtë synim, sepse, megjithëse vlojnë nga dëshira, ato luajnë rolin e indiferentes, pasi janë shumë më të shqetësuara për opinionin e shoqeve të tyre. Për shkak të kotësive të tilla, gjithë ai grim dhe ajo përgatitje u shkon dëm.

Unë mendoj se shumë femra e teprojnë me fiksimin e tyre me pamjen e jashtme dhe ndërkaq, po të njëjtat ankohen tërë kohën se meshkujt i shikojnë vetëm si copa mishi, kur vetë ato i shtynë ta kenë këtë qëndrim. Ato nuk e kuptojnë se nuk mjafton vetëm bukuria e jashtme për të bërë një mashkull të ndiejë vërtet diçka për të. Bukuria është vetëm një ngacmim i parë, diçka që të tërheq vëmendjen në fillim. Gjithçka që vërtet e ngazëllen një shpirt dhe e bën të tërhiqet drejt një shpirti tjetër, fshihet në mendje, në shpirt, në një buzëqeshje apo në një dorë që të përshëndet.

Tash do të flas pak për lacizmin, si një nga komplekset më të mëdha të meshkujve shqiptarë, i cili shprehet në formën e një fryrjeje të aftësive vetjake përtej masave reale. Shumë meshkuj janë më tepër të dhënë pas autoritetit të tyre, mënyrës se si do të duken në publik dhe se çfarë qëndrimi do të marrin të tjerët ndaj tyre, sesa pas femrës që dashurojnë. Luajnë rolin e idiotit të rëndësishëm, duke dashur që më çdo kusht të paraqiten sa më hijerëndë, deri në atë pikë sa disa nga këta fillojnë të besojnë se rëndësia e tyre rritet duke i shpërfillur deri në poshtërim të dashurat a gratë e tyre. Në të vërtetë, unë besoj se ajo çfarë fshihet pas kësaj hipertrofie personale, është një pasiguri therëse për veten, dëshirar apo aftësitë e tyre.

Por për më shumë keqardhje, është reagimi i femrave. Lacizmin e meshkujve që shprehet me ftohtësi, arrogancë e shpërfillje, femrat e interpretojnë si element të burrërisë së tyre, si diçka tërheqëse. Ato mendojnë se kjo tregon karakter të fortë.

Për mua, kjo është dëshmi se, atëherë kur dashurohen, femrat e humbin tërësisht mendjen dhe nuk dinë më se çfarë bëjnë, sepse vetëm dikush që e ka të dehur logjikën, mund të dashurohet deri në fiksion vetëm pse ai tipi nuk ia var fare. Që ironia të jetë më e madhe, këtë fakt as nuk e fshehin, madje kur i pyet pse janë dashuruar kaq marrëzisht, si budallaçka të thonë: “Sepse nuk ma var fare”. Me thënë të vërtetën, këtu më shumë shkon ajo shprehja kosovare “Nuk ma fut hiq” që, edhe pse tingëllon më vulgare, e shpreh thelbin e problemit.

Këto femra që dashurohen pas këtyre meshkujve e bëjnë këtë pasi ai është shëmbëlltyrë e meshkujve me të cilët janë rritur, baballarët apo vëllezërit. Modeli i mospërfilljes dhe dhunës psikologjike në shtëpi u duket si i vetmi dhe më i miri i mundshëm.

Një situatë akoma më tragjiko-komike krijohet kur ai tipi nuk është vetëm mospërfillës, por edhe kurvar. Edhe pse e di se ai është një kurvar i madh, përsëri ajo tërhiqet drejt gënjeshtreve të tij. E bën këtë edhe pse e di se po të njëjtat fjalë ia ka thënë kushedi sa shumë të tjerave. E bën këtë, sepse ushqen një bindje naive se do të jetë pikërisht ajo që do ta mbledhë, do ta disiplinojë dhe do ta mbushë me mend. Bie në kurthin e po të njëjtit naivitete ku më parë kishte rënë edhe mamaja e saj.

Po ta mendosh thellë, nuk duhet t'i akuzojmë këta meshkuj se sillen keq ndaj femrave, përderisa arroganca e tyre përjetohet si diçka tërheqëse dhe u kërkohet që të sillen kështu. Më makabërja është se, kur këto gjëra ua them mikeshave të mia, ato më shikojnë thuajse si jashtëtokësore. Ato besojnë se, pavarësisht se ata sillen ftohtë, diku brenda tyre fshihet dashuria për to. Më vjen të ulërij prej budallallëkut të tyre. Nuk e kuptojnë që, nëse ai nuk e tregon dashurinë, atëherë as nuk e ndien.

Një kompleks tjetër që po ashtu mund të futet në konkurrencë për listën botërore të budallallëqeve, është bindja e meshkujve se, pasi kanë fituar zemrën e një femre, duhet të marrin rolin e një autoriteti rregullues për të dëshmuar kështu burrërinë e tyre. Ky kompleks e shpjegon transformimin nga një ëngjëll i dashur në një djall të ftohtë.

Kur më vardisen dhe janë në ethet e fillimit të dashurisë, mashkulli është shumë qenie e këndshme që vrapon të më plotësojë çdo dëshirë. Por, pasi e arrin qëllimin e tij, ai shndërrohet në një qenie mizore që e shpërfill çdo mendim e dëshirë timen.

Një mikeshë ime ma ka përshkruar kështu ndryshimin në sjellje të të dashurit të vet: "Në fillim qeshnim me të gjitha ato

gjërat e vogla, të shkujdesura dhe komike që bënte gjithsecili dhe në emocionin e humorit përfundonim në përqaftime. Më pas, filluam të grindemi për po të njëjtat gjëra dhe përfundonim në ulërime, pasi ai kërkonte nga unë që të tregohesha e përmbajtur e të tregoja kujdes në çdo gjë. Sipas tij, kjo ishte mënyra se si duhet të sillet një vajzë që është në lidhje serioze. Domethënë, në çastin që u bëmë çift, nuk guxonim të ishim si më parë."

Ti thua se meshkujt dhe femrat i bëjnë konkurrencë njëri-tjetrit se kush do të tregohet më i ftohtë dhe më shpërfillës.

Dallimi është se femrat këtë e bëjnë para se të fillojë lidhja, ndërsa meshkujt e bëjnë pasi të fillojë lidhja. Natyrshëm, më lind pyetja nëse njerëzit vërtet dinë të jenë të lumtur apo qëllimisht e fusin vetën në një cikël të ngacmimit dhe të lëndimit të tjetrit. Gjithë atë energji që e investojnë për ta provokuar dhe lënduar tjetrin, sikur ta orientonin në shprehje të kujdesit nuk do të kishim nevojë për psikiatër.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Unë: Si mund ta ndiejë njeriu mungesën e dikujt që ia thyen zemrën, që shkel mbi gjithçka dhe që e merr për të mirëqenë?

Zonja Z: Këtë pyetje bëj tërë kohën dhe nuk gjej dot përgjigje.

Unë: A thua dashuria është vetëm një formë e marrëzisë? Marrëzi e veshur me petk të dëlirësisë? Marrëzi që ta deh shpirtin dhe të shtrin mbi shtratin me gjemba ku plagët të kullojnë si plagë vdekjeprurëse që nuk i ndien derisa bëhet tepër vonë?

Zonja Z: Për këtë ndonjëherë unë trembem nga dashuria, sepse ajo ka fuqi të tmerrshme transformuese: njeriun e hareshëm mund ta kthejë në një depresiv të shpifur; njeriun e kujdesshëm deri në detaje mund ta kthejë një lolo tërësisht të shkujdesur; një njeri të mençur mund ta kthejë në budalla; një të pasur brenda një nate mund ta kthejë në të varfër... I bën të gjitha këto dhe shumë më shumë se kaq. Shkrimtarët si puna jote, artisti im i dashur, duan të na bëjnë të besojmë se dashuria e ka fuqinë e transformimit edhe në kah të kundërt. Nuk e di, mbase dhe mund të jetë e vërtetë, por mua nuk më ka ndodhur e as nuk kam parë diçka të tillë. Së paku jo në këtë realitet ku unë frymoj.

DILEMA E ËMBËL

(mesazh për Zonjën Z)

A më dashuron vërtet?

Kjo është pyetja që nuk guxoj të bëj. Jo ngaqë trembem nga përgjigja jote, por kam frikë se as atëherë nuk do të të besoj. Ndonjëherë mendoj se gjithçka që kam nevojë, është të më thuash se nuk po i bie murit me kokë dhe se nuk po e mashtroj veten.

Prandaj më nuk do të të pyes: "A më dashuron vërtet?"

Në vend të kësaj, do të lutem që të mos zgjohem kurrë nga kjo ëndërr, sepse e tillë është jeta me ty: një ëndërr nga ato të bukurat që pakkush e beson.

PARADOKS MASHKULLOR

Duam femra që na nënshtrohen, ndërkaq çmendemi pas atyre që rrezatojnë siguri dhe autoritet. Jo vetëm që duam t'i bëjmë për vete, por edhe të marrim diçka nga magjia e tyre. Ky është paradoksi i botës mashkullore.

Nuk di ta shpjegoj pse, por me siguri ka të bëjë me kujtesën gjenetike të njerëzimit. Në fillim, ne meshkujt dilnim për gjah, bënim punët e komunitetit, trulloseshim me gjethe e lule të ndryshme dehëse dhe ishim të gatshëm që në çdo kohë të bënim seks. Ky ishte funksioni dhe roli ynë në shoqëri. Në zhargonin e ditëve të sotme, e gjithë kjo do të përkufizohej si *Sex, drugs and rock'n'roll*. Asokohe, askush s'e vriste mendjen për pushtet e dominim dhe gruaja adhurohej si hyjni.

Pavarësisht mbizotërimit që ndërkohë kemi fituar, në nënvetëdijen tonë, njësoj si të parët tanë, vazhdojmë të tërhiqemi nga ato femra që natyrshëm rrezatojnë siguri dhe autoritet.

TË JESH HERO

(shënim i Zonjës Z)

Më pëlqen që ti më pranon ashtu siç jam. Më pëlqen që nuk më gjykon pse jam botë më vete. Më pëlqen që nuk turbullohesh fare kur ndodh që të takojmë ndonjë nga ish të dashurit e mi, pasi ti e ndien se unë jetoj të tashmen dhe se e tashmja ime je ti. Më pëlqen që me ty ndihem e çlirët dhe që të eksiton përvoja ime. Por ajo që më mrekullon, është përkrahja që gjej te ti sa herë vendos që dikujt t'ia përplas në fytyrë fëlliqësirat e veta. Është ndjenjë e bukur të ndiesh mbështetjen e njeriut që do.

Mbrëmë më the se ty nuk të habit më asgjë tek unë, por megjithatë do të doje të dije se si ia dal që të jem e hapur dhe ta them atë që vërtet mendoj, pa u brengosur për atë çka mund të thonë apo mendojnë të tjerët.

Nuk është e lehtë, por as e vështirë. Së paku jo aq vështirë sa thonë ata që tërë jetën e tyre e kanë kaluar nën hijen e të tjerëve.

Duhet guxim!

Duhet guxim për t'u ballafaquar me paragjykimet dhe intrigat e mëdha të kësaj botës sonë të vogël. Për shembull, ende vazhdon të jetë e rrezikshme të flasësh haptas për dëshirat

dhe përvojat e tua, sidomos ato të nxehtat, që me një mendim të vetëm mund të të bëjnë të lagesh aty poshtë. Kjo, në një rreth si ky yni ku sundon poshtërsia dhe logjika e nënshtrimit, nuk bëhet. Sidoqoftë, duke qenë se edhe ti je pjesë e tij, besoj e ke kuptuar se duhet diçka më shumë.

Duhet guxim dhe vërtetësi!

Nuk mund të jesh i drejtë me të tjerët nëse je mizor ndaj vetvetes. Nuk mund të jesh i vërtetë me botën, nëse të vërtetën ia mohon vetes. Dhe as mos të të shkojë mendja se ndonjëherë do t'ia dalësh të mposhtësh paragjykimet e të tjerëve, nëse së pari, nuk je i hapur ndaj vetes.

Nuk duhet ta mohojmë që paragjykimet e të tjerëve dhe intrigat para e pas shpine na lëndojnë. Na lëndojnë shumë. "Mua nuk më plas fare për atë çka mendojnë të tjerët." Ata që e thonë këtë, sado që çirren, duke u përpjekur të na bindin për të kundërtën, në të vërtetë tashmë janë dorëzuar para paragjykimeve dhe intrigave të të tjerëve. Duke u përpjekur të bëhen të pranueshëm, janë lodhur aq shumë, sa që tani nuk kanë më fuqi për asgjë tjetër. Fjalët e tyre, përfshirë edhe britmën se "nuk u plas fare", nuk janë thirrje të lirisë, por janë klithje zhgënjimi të dëshpëruarish.

Në një situatë të tillë, është shumë e vështirë të jemi të vërtetë.

Sidomos atëherë kur e ndiejmë presionin e poshtërsisë së krijuar nga paragjykimet dhe intrigat. Na duhet vërtetësi dhe guxim që të përballemi me të ardhmen. Kjo mund të na lëndojë edhe më shumë, sepse të pushtetshmit e kësaj bote, qofshin ata politikanë, biznesmenë, dashnorë xhelozë, prijës

të çmendur fetarë, banditë dhe kriminelë, nuk e pëlqejnë situatën ku njerëzit thonë atë që vërtet mendojnë. Do të bëjnë çmos që të mos lejojnë asnjë skenar ku njerëzit marrin guximin të flasin lirshëm, të veprojnë pa frikë. Tragjikja është se kjo mani e të pushtetshmëve për të luftuar të vërtetën me paragjykimet dhe intriga kopjohet edhe nga shumë të tjerë: nga miqtë tanë, nga familjarët dhe jo rrallëherë edhe nga ata që dashurojmë.

Ballafaquar me këtë situatë, shumica, me vetëdije, zgjedhin të heshtin. Është pothuajse aventurë vetëvrasëse nëse vendos që me çdo kusht të thuash atë që vërtet e mendon, sepse do ta shohësh veten si subjektin kryesor të të gjitha intrigave dhe thashethemeve. Një pasion dhe guxim i tillë është diçka që nuk të leverdis, diçka ku nuk të del hesapi mirë. Por, nëse je i vetëdijshëm për të gjitha pasojat e të gjitha rreziqet dhe ende ngulmon të jesh në mesin e atyre pak njerëzve që nuk përulen e thonë atë që vërtet e mendojnë, atëherë dije se je një HERO.

Sikur të mos ishin njerëzit e tillë, njerëzimi do të vazhdonte të ishte në epokën e shpatave dhe të shigjetave dhe sporti popullor do të vazhdonte të ishte djegia e shtrigave.

Inkuizicioni asnjëherë nuk është tejkaluar, vetëm sa është maskuar dhe është bërë më i fshehtë.

Në këtë botën tonë të vogël shqiptare, vazhdon të ketë shumë dhimbje dhe vuajtje të shkaktuar nga njerëz që mendojnë se mund t'ia bëjnë gjyqin moral tjetrit. Dhe, pavarësisht dëshirës sonë të shitemi si një shoqëri e emancipuar, bartësit kryesorë të kësaj dhimbjeje dhe vuajtjeje vazhdojnë të jenë femrat. Ka pak

rëndësi nëse jetojmë në fshat apo në qytet, jemi të varfër apo të pasur, pavarësisht gënjeshtreve që shesim në TV e gazeta, në mendësinë tonë kanë ndryshuar shumë pak gjëra.

DASHNORJA E SHEFIT

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Një femër shqiptare, nëse është e varur nga puna, pavarësisht sa e zonja dhe e dijshe, ballafaqohet me kushtëzime aspak dinjitoze.

Shpesh jam gjetur përballë situatës ku me mua kanë dashur të abuzojnë vetëm e vetëm pse janë ndier të fuqishëm. Sapo shefi ka kuptuar se kisha pak ambicie për të përparuar në punë, menjëherë ka marrë guximin të më tregojë rrugën më të shkurtër drejt suksesit: bëhesh dashnorja e shefit dhe më pas sukseset vargëzohen varësisht prej angazhimit që tregon në shtratin e tij.

Nuk ka gjë më të pështirë sesa një mashkull që, sapo zotëron pak pushtet e para, nis të mendojë se kjo i jep të drejtën që ta fusë atë veglën e vet kudo t'i pëlqejë. Nuk ka gjë më të këndshme sesa t'ia përplasësh të vërtetën në fytyrë këtyre njerëzve.

Nuk e kam bërë se kam dashur të luaj rolin e shenjtores. Madje, ndonjë nga këta shefat edhe mund të më ketë pëlqyer, por gjithnjë më kujtoheshin fjalët e një mikeshës sime, e cila, e gjendur përballë një situatë të ngjashme, thoshte: "Nuk e kam problem të bëhem dashnorja e shefit, sepse e vërteta është që shefi është tip i lezetshëm, por çfarë të bëj nëse ndërkohë

ndërrohet shefi dhe në vend të tij vjen një katundar barkalec që kundërmon erë mishi dhe hudhre.” A do të thotë kjo se duhet të bëhem edhe dashnorja e shefit të ri?

Duke i lënë shakatë mënjanë, kot flasim për emancipim dhe barazi midis sekseve, derisa këto pislleqe vazhdojnë të ndodhin para syve të të gjithëve. Shumë mendojnë se ato që përballen me këtë problem, i kanë provokuar vetë shefat, prandaj ato janë të detyruara të heshtin, ndërsa shefat barkalecë mund të vazhdojnë të shpresojnë se fati do t'u ecë te viktima e radhës.

SHPËTOMË

(mesazh për Zonjën Z)

E dua një grimcë nga shkëlqimi yt.

Vetëm pak nga magjia me të cilën të gjithë i bën për vete.

Pakëz jetë që të shpëtoj nga verbëria e dëshpërimit.

Më jep pak nga ajo që je Ti.

DELIKATESË DHE HELM

(shënim i Zonjës Z)

Mbrëmë ti më tregove për një ngjarje të shëmtuar që të kishte rastisur në një nga *pub*-et e metropolit.

Një çift kishte përfunduar në grindje dhe ulërima pasi djali ishte bërë nervoz që meshkujt e tjerë e sodisnin të dashurën e tij. Sipas teje, ata nuk kishin pasur faj, pasi ajo vërtet ishte e bukur dhe nuk mund ta kuptojë pse çifti ishte grindur për diçka të tillë.

Meshkujt shqiptarë e kanë shumë të vështirë t'i përballojnë situatat ku të tjerët ua sodisin gratë apo të dashurat e tyre. Natyrisht, nuk po flas për ato situatat e sikletshme kur kemi të bëjmë me shikime të pashqitshme që vërtet të bezdisin e për të cilat shqiptarët dinë të jenë ekspertë, por vetëm për ato raste kur njerëzit të sodisin thjesht për admirim. Reagimet e pamatura të meshkujve nuk janë gjë tjetër veçse shprehje e pasigurisë së tyre, pasi është budallallëk të mendosh se mjaftojnë disa shikime nga dikush që një femër të trulloset. Një qasje tillë është shumë fyese e nënkupton një mendim shumë të ulët për femrën. Çfarë qenka ajo nëse u mjaftuaka me kaq? E çmendur, budallaqe, naive apo e përdalë? Për më tepër, nëse ai mendon që ajo mund të jetë e tillë, atëherë pse rri me të?

Sa herë kam dëgjuar fjali të tilla si "xhelozia është shumë e përhapur ndër shqiptarë" apo "xhelozia është tipike për shqiptarët"! Këto mbase dhe janë të vërteta, por janë të vërteta për shqiptarët, po aq sa edhe për të gjithë popujt e tjerë.

Disa thonë se xhelozia është sëmundje, veti e njerëzve të ligj, shprehje e një karakteri të ulët dhe shumë e shumë të tjera. Moralizime të kota! Të gjithë jemi të njëjtë.

Njeriu është xheloz në gjithçka, duke filluar nga dashuria e deri te suksesi i tjetrit. Kjo e bën atë të vuajë në një ankth të pafund.

A e di pse?

Dyshimi i vazhdueshëm, që është motori kryesor i xhelozisë, nëse kthehet në filozofi të jetës, është ftesë për vuajtje.

Në shprehjen e xhelozisë së tyre, meshkujt janë brutalë, një millef që mblidhet dhe shpërthen në një shfryrje të egër dhe herë-herë edhe të përgjakshme. Ndërkaq, femrat janë më dinake dhe këmbëngulëse; ajo në vazhdimësi, si një qukapik, i troket mashkullit në kokë dhe nuk heq dorë nga qëllimi i saj.

Mendoj se xhelozia nuk është gjë tjetër veç shprehje e mungesave tona.

Ti më pyet a jam xheloze.

Unë jam e çmendur.

Ti po qesh me mua, por edhe unë jam qenie me mish e kocka. Mashkullin tim e dua vetëm për vete dhe nëse është nevoja, do ta çmend duke i trokitur vazhdimisht në kokë. Kohë

pas kohe do t'ia fus thonjtë në pjesët e buta të trupit, do të shtrëngoј dhëmbët, do të bërtas, do të qaj, por asnjëherë nuk do ta lëshoj.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Unë: Xhelozia jote mua më duket argëtuese, por më çmend këmbëngulja jote që me çdo kusht t'i dalësh në fund një historie dyshimi që mund të kesh.

Zonja Z: (qesh) Nuk mund të luash me zjarrin dhe në të njëjtën kohë të besosh se nuk do të digjesh.

Unë: Pranoje se ndonjëherë vërtet e tepron. Bëhesh xheloze edhe për gjëra të kota.

Zonja Z: Si mashkull që je, nuk e kupton se një femër e ka të vështirë të pranojë praninë e një tjetre që sillet përreth të dashurit të saj.

Unë: Por në sytë e mi, ti je gjithnjë më e mira dhe më e bukura.

Zonja Z: Atëherë këtë të ma thuash shumë shpesh.

TË DUA!

(mesazh për Zonjën Z)

Të dua edhe atëherë kur çmendesh në histeri xhelozie.

*Madje edhe kur bëhesh si budallaqe dhe ma dhunon mendjen
me ca teori që vetëm ti di t'i shpikësh.*

*Do të të dua edhe kur të plakemi e të mendosh se nuk je e bukur
më.*

*Do të vrapoj pas teje, njësoj si ditën e parë, kur sajoja arsye
vetëm që të isha pranë.*

*Ti gjithnjë do të jesh ajo ëndërr nga e cila do të refuzoj të
zgjohem.*

Ndieje dashurinë time!

Të dua!

Të dua, sepse ti më plotëson!

KRIMI I PËRSOSUR

(shënim i Zonjës Z)

Kam besuar se bota ishte e mirë. Kam besuar se mjafton të dëshirosh diçka dhe ajo realizohet. Kam besuar... Më pas jam zhgënjyer. Bota jonë nuk është ashtu siç e ëndërrojmë dhe as ashtu si e himnizojmë në traktatet filozofike. Fatkeqësisht, bota është e zymtë. Dhe saktësisht ashtu siç e kemi formësuar ne vetë.

Unë nuk jam as filozofë, dhe as si ti, që na mbahesh si njeri i pendës dhe i mendimeve të bukura. Por ama, unë dhe të tjerët si unë, që të fuqishmit e kësaj bote na shpërfillin, kemi shumëçka për të thënë, sepse ne jemi veteranë të luftës së përditshme. Dhe pa e ndier në lëkurën tënde egërsinë që të gllabëron, askush nuk ka të drejtë t'i flasë dikujt tjetër për vështirësitë e jetës, aq më pak t'i tregojë se si duhet ta jetojë jetën e vet.

Lufta e përditshme është një luftë shumë e vrazhdë, ku në heshtje, pa u vënë re nga askush, një njeri shqyen një njeri tjetër dhe nuk ndalet derisa t'ia nxjerrë edhe dromcën e fundit të jetës. Kjo është arsyeja pse, sa herë që del, qoftë edhe për një shëtitje të vogël, do të shohësh plot njerëz të lënduar. Nuk u sheh gjak dhe as plagë, por në sytë e tyre mund ta ndiesh se janë të plagosur në vetë thelbin e qenies së tyre. Për mua, ky është krimi i përsosur.

Dua të besoj se Zoti vërtet e ka kurorëzuar njeriun si mëkëmbës të vetin në Tokë dhe se ka një kuptim përtej ekzistencës sonë fizike. Por kjo mëkëmbësi do të duhej të kuptohej si një detyrë me shumë përgjegjësi dhe jo patjetër si pushtet; si një shtytje që të tregojmë përkujdesje dhe dashuri për çdo njeri e gjallesë tjetër. Por njeriu nuk bën ndonjë gjë të përgjegjshme, veç abuzon me pushtetin e tij, duke e vënë veten në nivelin e kafshës më grabitqare dhe më të egër që ekziston.

Grabitqarët gjithnjë janë në rivalitet me njëri-tjetrin, në një gjendje të përhershme konkurrence për çdo gjë dhe hiç gjë. Të tillë jemi, madje shumë më të këqij. Prandaj nuk janë luftërat, as ndarja e njerëzve në raca, fe, gjini, popuj e shumëçka tjetër që e ka zymtuar botën. E keqja e kësaj bote mbështillet përreth mënyrës së mbrapshtë se si njeriu e kupton konkurrencën: njerëzit nuk jetojnë, por shryhen me njëri-tjetrin. Jemi vetë përgjegjës për shkatërrimin e vetes, shoqërisë, mjedisit dhe botës. Për t'u bërë vetë më i pasur, njeriu është në gjendje të varfërojë miliona të tjerë, të shkatërrojë natyrën, të zhdukë raca të tëra gjallesash të rralla e shumë të tjera. Për të dëshmuar superioritet, njeriu është në gjendje ta hajë për së gjalli një njeri tjetër. Nuk ka kufi egërsia e njeriut. Nuk duhet të jesh shumë e mençur për ta kuptuar këtë.

“Është zbehur njerëzorja.” Kjo është përgjigjja jonë për të gjitha këto, thua se ky është vetë zbulimi i madh i shekullit.

Me çfarë matet njerëzorja?

Me dashuri. Me përkujdesje. Për çdo njeri dhe për çdo gjallesë tjetër.

Nuk po them asgjë të re. Të gjitha këto ose i ka thënë dikush më herët apo secili nga ne i mendon. Po pse atëherë asgjë nuk ndryshon?

PURISTËT

(shënim i Zonjës Z)

Mbrëmë bëmë diçka që nuk e kemi bërë kurrë: edhe ne i ndoqëm lajmet, pasi e gjithë dynjaja këto ditë po merret me xhihadistët.

Për mua, këta dhe ekstremistë të tjerë pa dallim cilës fe apo ideologji i takojnë, janë të njëjtë me shenjtorët e rremë që shesin moral poshtë e lart. Në sytë e tyre, tipat si unë, që duan të jetojnë të lirë prej skemave dhe dogmës së tyre, janë heretikë. Po të mundnin, nuk do të ngurronin që të na ekzekutonin me gurë në mes të sheshit.

Puristë që vuajnë nga kompleksi i sëmurë për ta luajtur rolin e Zotit në versionin e një despoti mizor. I japin vetes të drejtën të gjykojnë dhe t'u tregojnë të tjerëve si duhet të jetojnë. Me aq zell e luajnë këtë rol, saqë nuk janë fare të vetëdijshëm se shndërrohen në personazhe të komedive të zeza.

Flasin me fraza të pakundërshtueshme, sepse çmendurisht besojnë se i dinë të gjitha. Mendojnë se mund ta përcaktojnë normën e pranueshme për çdo gjë: atë çka është normale dhe jonormale; atë çka është e drejtë dhe jo e drejtë; atë çka është e moralshme dhe e pamoralshme. Dhe më e trishta në këtë mes është pafuqia jonë përballë tyre.

E kupton pse këta njerëz veprojnë kështu?

Ata duan të luajnë rolin e Zotit, por, në të njëjtën kohë, e zhveshin veten nga çdolloj mëshire. Në sytë e tyre, bota është e ligë, e sëmurë dhe si e tillë duhet pastruar nga e keqja.

Edhe pse nuk e thonë, jam shumë e bindur se tinëzisht, thellë brenda vetes, janë të bindur se Krijuesi që ata e deklarojnë si autoritet absolut e të pagabueshëm, ka bërë gabime gjatë krijimit dhe tani është detyrë e tyre që t'i përmirësojnë këto gabime. Në logjikën e tyre të marrë, këto "gabime" mund të përmirësohen vetëm me shpatë e zjarr. Nuk janë në gjendje ta kuptojnë se asgjë nuk shërohet duke shkaktuar më shumë dhimbje. Aq më pak shpirti dhe zemra e njeriut.

KRAHËT E LIDHUR

(shënim i Zonjës Z)

Përballë dështimit të vet, njeriu e ka të vështirë, pothuajse të pamundur, ta pranojë qoftë edhe mundësinë teorike se dikush nga rrethi i tij mund të ketë sukses. Na duan për ëndrrat tona, për shkëlqimin e bukur të fluturimit plot vetëbesim, por, në vend të na bëhen bashkudhëtarë, bëjnë çmos të na i lidhin krahët. Na duan sepse jemi të shpejtë, të vendosur, plot siguri, por nuk mund të na durojnë si të tillë dhe synojnë të na i lidhin këmbët që të mos e hedhim hapin tjetër. Përballë kësaj, nuk duhet shumë mend për ta zbuluar shkaku pse ndihemi të lodhur, të rraskapitur e të zhgënjyer. Përballë ironisë së jetës, thjesht e humbim besimin në të bukurën, e humbim besimin se ia vlen të angazhohesh dhe të bësh diçka më shumë.

E ke vënë re si një ëndërrimtar (kështu i quaj të gjithë ata në shpirtin e të cilëve ende ndriçon drita e pasionit të pastër dhe e mendimeve të bukura) rreket që, me entuziazmin më të madh, ta ndajë ëndrrën e vet me dikë tjetër. Por nuk arrin as ta tregojë mirë, pasi menjëherë fillon vala e shkurajimit. Ëndërrimtari pret përkrahje, por merr vetëm një thes me dyshime: "Nuk e besoj se mundesh. A je i sigurt se di ta bësh këtë? E ke menduar se çfarë do të thonë të tjerët?" Nuk ndalen derisa dhe vetë ëndërrimtari fillon të dyshojë në veten e tij.

Nuk ka gjë më të poshtër sesa të helmosh me farën e keqe të dyshimit një shpirt pasionant. Dyshimi mund ta shuajë flakën e pasionit të pastër. Kur fara e tij lëshon rrënjë në shpirtin e njeriut, atëherë pasioni spostohet në plan të dytë. Në këtë gjendje edhe njeriu me vetëbesimin më të madh bie në hamendje dhe, sado të përpiqet, nuk mund t'ia dalë. Dhe këtu fillon ironia e radhës: ëndërrimtari heq dorë dhe askush më nuk merret me të, madje e shpërfillin dhe e trajtojnë si dështak.

Prandaj unë kurrë nuk do të lejoj që dikush të m'i lidhë krahët, të ma helmojë shpirtin me dyshime dhe të ma fikë pasionin. Nuk do t'ia jap askujt kënaqësinë që të mund të më shpërfillin si një dështake. Ëndrrat e mia janë e vetmja gjë që më mban gjallë. Jetojmë nën presionin e atyre që janë gjithnjë gati të të numërojnë gabimet dhe të t'i rrënojnë idetë, ende pa u formësuar ato mirë; të atyre që si vampirë ushqehen me dëshpërimin e të tjerëve; të atyre që ta thithin edhe dromcën e fundit të dinjitetit e si në një ankth prej të cilit nuk mund të zgjohesh, të tërheqin drejt humnerës.

Për të shpëtuar prej tyre ka vetëm një zgjidhje: duhet shporrur frika jonë, sepse këta vampirë fuqizohen vetëm nga ajo.

VETËM Z!

Në fillim e kam quajtur Zonja Z, sepse gjithnjë kam dashur të kem një Zonjë Z, siç e kishte Pushkini. Por, edhe pse në fillim jam tërhequr drejt saj me qëllimin që të kem një dashnore sekrete që ta shkërmoq trupin dhe ta ndez flakë zemrën, shumë shpejt e kuptova se mbi të gjitha kisha fituar një mësuese të jetës. Prandaj nuk jam bërë si gjithë të tjerët, i dhënë vetëm pas projeksonit që kisha krijuar për Z-në, por vullnetshëm jam shkrirë në botën e vërtetë të saj. Ajo e quan veten: Vetëm Z! Dhe ngulmon që kështu ta njohin edhe të tjerët.

DIALOG NË KRYQËZIMIN E BOTËVE

Unë: Pse Z?

Zonja Z: Z është për Zombi. Një femër që vendos ta jetojë të vërtetën e vet dhe refuzon ta luajë rolin e kukullës së bukur dhe të pafjalë, rrezikon të syrgjynosë veten, ta shohë veten të braktisur, të përgojuar dhe të përbaltur. Dhe nëse ngulmon e nuk heq dorë, atëherë do t'i shohë edhe njerëzit e vet duke u shmangur prej saj, si të ishte një e vdekur mes të gjallëve. Një Zombi!

DIKTATURA E TË DËSHPËRUARVE

(shënim i Zonjës Z)

Të gjithë flasim për lumturinë, por shumë pak prej nesh e jetojnë atë dhe kanë guxim të bëjnë të domosdoshmen për ta arritur. Të kërkojsh lumturinë, është një ndërmarrje e rrezikshme, sepse mund të zhgënjehesh: jo me lumturinë si ndjesi, por me njerëzit përreth teje. Njerëzit, në vend të gëzohen, në të vërtetë të kanë zili për lumturinë dhe do të të luftojnë tërë kohën. Do ta bëjnë këtë hapta dhe tinëzisht, para dhe pas shpine, kështu do të detyrohesh të heshtësh, të bësh kujdes e të ngurrosh që ta shfaqësh lumturinë. Do të bëhesh fatkeq. Kësaj i thonë ta gjesh lumturinë vetëm për ta parë se si ta rrëmbejnë para syve.

Aq shumë janë mbërthyer në trishtim dhe të jetuarit u është bërë aq i mërzitshëm, saqë futja e hundëve në punët e tjetrit është i vetmi argëtim që u ngjall ndonjë emocion. Përgojimet, thashethemet, intrigat – njëjtë si ajo reklama televizive “3 në 1” – janë sporti më i përhapur popullor. Të gjithë krahë për krah, të bashkuar në shkatërrim.

Trishtohem, sepse, pavarësisht sa përpiqemi që jetën tonë ta veshim me individualitet, në të vërtetë jetojmë nën diktatin e dëshirave, mërive dhe tekave të të tjerëve. Të atyre që gjithnjë janë të pakënaqur, të atyre që tërë kohën i fusin duart dhe

hundët në punët e të tjerëve, të atyre që kanë hequr dorë nga lumturia.

I gjithë ky shtjellim është goxha ironik. Njeriu jeton brenda hiçit, përherë në pritje që të ndodhë diçka e bukur, pastaj tmerrohet nga një mundësi që i jepet edhe pse ka tërë jetën që e pret. Ndryshimi për mirë përjetohet si traumë. Kështu mendojnë e jetojnë të dëshpëruarit dhe presin që edhe të tjerët të bëjnë njësoj.

Kjo është diktatura e të dëshpëruarve.

LUMTURIA

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Njerëzit kanë harruar të jenë të lumtur, madje kjo gjë u duket e pamundur. Nëse nuk më beson, atëherë mbylli sytë dhe kthehu pas në kohë. Kthehu në fëmijëri dhe do ta shohësh se vërtet ka ekzistuar një kohë kur secili nga ne dinte ta jetonte lumturinë. Bëje këtë dhe do ta kuptosh se lumturia fshihet brenda entuziazmit të fëmijës që çdo mbrëmje kënaqet duke dëgjuar të njëjtën përrallë.

LOTËT I MBAJ PËR VETE

(shënim i Zonjës Z)

Kur vjen në një moshë të caktuar dikush si unë (që ka parë, ndier dhe dëshmuar gjithë poshtërsinë dhe egoizmin e rrethit tonë), e sheh veten përballë dilemës: të sillet në përputhje me vitet që ka; të futet brenda kallëpit të shumicës që ngre zërin për çdo gjë, me përjashtim të atyre që vërtet kanë rëndësi apo të sillet në përputhje me mllëfin që ndien brenda vetes dhe që është mbledhur ndër vite?

Unë kam zgjedhur të dytën, sepse mendimi se mosha duhet të reflektojë qetësi dhe maturi, është vetëm një maskë më shumë. Unë mund të jem e qetë vetëm atëherë kur nuk ndiej mllëf brenda vetes. Pse duhet të sillem sikur gjithçka është në rregull? Apo ndoshta nga unë pritet që të shndërrohem në një statujë moderne, përherë e buzëqeshur dhe që poshtë e lart shpërfaqet me një fytyrë lavdiplotë që nga brenda ndihet e tharë?

Prej nga ka ardhur i gjithë ky mllëf?

Ka filluar nga pamundësia për të ikur nga skemat e realitetit tonë, pastaj ka kaluar nëpër ëndrrat që nuk realizova kurrë dhe është vulosur nën thundrat e zhgënjimit me njerëzit e mi që kurrë s'më përkrahën.

Fantazmat e ëndrrave të mia më ndjekin në çdo hap. Kërcejnë poshtë e lart në mendjen time. Kam diçka brenda vetes që tërë kohën mbliidhet të pëlcase, saqë më duket se në çdo çast do ta bëj kapërcimin e bëftë nga heshtja e thellë te shpërthimi i furishëm.

Njeriu ka një aftësi të veçantë për t'u përplasur egërsisht me veten. Është si një luftë që mund të më lodhë, por edhe më jep një kënaqësi të çuditshme. E kuptoj se nuk jam si ato të tjerat që mbahen falë një fasade, të cilën përpigën ta shesin si domosdoshmëri për t'u përshtatur me rrethin. Jo! Për mua, nuk ka fasadë që kryen punë dhe që mund ta shuajë vullkanin brenda meje.

Nuk je i pari që beson se, ngaqë dukem e fortë, ngaqë nuk përulem para askujt, jam immune ndaj dhimbjes dhe zhgënjimit. Por nuk është kështu. Edhe unë sfidohem me situata lodhëse. Ndonjëherë kjo gjendje shkon edhe më larg, saqë ndihem e padëshiruar – tepricë e botës, që nuk do t'i mungojë askujt.

Sado që të shtiren se vërtet ju intereson, askush nuk do t'ia dijë për ato që vërtet më djegin në shpirt. Të paktë janë ata që më duan ashtu siç jam vërtet. Më duan të gëzuar si një kotele që mjaftohet me pak ledhatime. Më duan të bindur si një skllave që e di se nuk ka fuqi mbi jetën e vet. Më duan të bukur si një kukull që mund ta shfaqin kudo ku u duhet. Por më duan edhe të pagojë që të mos protestoj. Të tillë më duan! Jo ndryshe!

Pa fije turpi më thonë: "Bëhu e arsyeshme!"

Më vjen të qesh me zë. Si nuk po e gjejnë një fyerje tjetër? Së paku diçka më origjinale. Në djall gjithçka! Jam lodhur së qeni e arsyeshme.

FLLUSKA

(shënim i shkurtër i Zonjës Z)

Ne jetojmë në një fluskë. Ky fakt është fillimi dhe fundi i çdo gjëje. Jetojmë brenda një varreze, ku jemi të varrosur për së gjalli bashkë me të gjitha ëndrrat tona.

MURI KINEZ

(shënim i Zonjës Z)

Themi se duam të jemi pjesë e botës, ndërkaq, në të njëjtën kohë, këtë copë të vogël të botës ku frymojmë ne e kemi rrethuar me një mur të madh e të padukshëm. Njësoj si ai muri i madh kinez. Vetëm se nuk e kam të qartë nëse po mbrohem nga ata jashtë murit apo po i mbrojmë ata nga vetja jonë.

DIALOG NË KRYQËZIM TË BOTËVE

Unë: Si je sot?

Zonja Z: Njësoj. Punë, përditshmëri dëshpëruese... E njëjta gjë si dje.

Unë: Sa ta ngjashëm jemi të gjithë. Nuk dimë si të jemi të lumtur. Idenë e lumturisë e rrisim dhe e stërmadhojmë. E kthejmë në një mit, saqë edhe vetë fillojmë të besojmë se është diçka e paarritshme.

Zonja Z: Ndërkohë pa mëshirë i lëndojmë të tjerët, në mënyrë që më pas ata të na kthejnë borxhin. Madje, edhe ata që i duam më shumë. Rreth vicioz!

Unë: Nesër nuk do të pyes "si je?".

Zonja Z: Bëje po të duash, por përgjigjja do të jetë e njëjtë. Ndërron vetëm dita.

MIK

(shënimi i fundit i Zonjës Z)

Sonte dua një shok afër vetes.

Një që nuk më gjykon.

Një që nuk më bombardon me një milion pyetje.

Një që, vetëm për hatrin tim, do të dehej vetëm me aromën e trishtimit tim.

Një, të cilit pa frikë mund t'ia hap zemrën dhe t'ia tregoj të gjitha.

A ka më shokë të tillë?

Tregomë!

Më duhet vetëm një.

GABIMI

Këtu përfundojnë shënimet e Z-së, edhe pse me të drejtë mund të duket se rrëfimi i saj ende nuk ka filluar mirë e se gjërat më të rëndësishme kanë ngelur pa u shkruar. Por besoj se deri tani e ke kuptuar edhe ti që Z-ja nuk është dikush që i jep llogari dikujt apo ka dëshirë të arsyetohet mbi veprimet e saj. Kur e pyeta se pse nuk vazhdoi t'i shkruante shënimet e veta, më tha se kishte ndryshuar mendje dhe se mendonte që bota nuk duhej t'i lexonte mendimet e saj. Ajo trembej se dikush do të frymëzohej dhe sipas saj nuk do të fitonte gjë nga rebelimi.

"Rebelimi është një sipërmarrje shumë e shtrenjtë, sepse nënkupton një faturë shumë të madhe që jo secila mund ta përballojë. Është një përpjekje e vazhdueshme, plot dhimbje dhe sfida sfilitëse. Bota i adhuron rebelet, por askush nuk e do dhimbjen që ato ndiejnë. Nuk dua që dikush tjetër të ndiejë dhimbjen që jetoj brenda meje!" Këto ishin fjalët e saj teksa kërkoi nga unë që t'i shkatërroja shënimet që më kishte dërguar ndërkohë.

Por, edhe pse e kisha të rëndë që të shkoja kundër vullnetit të saj, unë nuk iu binda, sepse besoja se shënimet e Z-së ishin me vlerë. Për më tepër, besoja se bota duhet ta njohë Z-në. Mbase rebelimi sjell dhimbje, por a nuk është ky një nga ligjet themelore të natyrës? Çdo ndryshim, madje edhe ardhja

në jetë e një shpirti të ri, kalon nëpër një fazë dhimbjesh të papërshkrueshme, por në fund, atëherë kur del në breg, e sheh se ia ka vlejtur.

Kështu mendoja asokohe dhe me këtë e arsyetova vendimin tim që të mos i shkatërroja shënimet e Z-së. Po njësoj arsyetova edhe vendimin tim që ta gënjeja Z-në. I thashë së i kisha djegur shënimet e saj, duke menduar se në një fazë të mëvonshme do ta bindja që kisha vepruar drejt. Kjo gënjeshtëri e vogël e imja, edhe pse e ngjizur me qëllime të mira, u bë shkak që Z-ja të ndryshonte tërësisht qasje ndaj meje. Të kota ishin të gjitha përpjekjet e mia që ta bindja për të kundërtën. Më akuzoi se edhe unë isha si të gjithë të tjerët dhe se, në vend që të mendoja për të dhe për ndjesitë e saj, po mendoja vetëm për veten dhe karrierën time.

Ajo që asokohe nuk mund të parashikoja, që shkalla e lartë e zhgënjimit të saj me mua. Refuzimin tim që t'i shkatërroja shënimet e saj, si dhe gënjeshtren time të mëpasshme, Z-ja e kuptoi si zhvlerësim të intimitetit dhe besimit të ndërsjellë që kishim krijuar mes njëri-tjetrit. Më tha se ndoshta do të mund të pajtohej që shënimet e saj t'i përdorja diku, por asnjëherë nuk do të mund të më falte pse e kisha gënjyer. Sipas saj, në raportin tonë kishte vend për gjithçka, pos për gënjeshtër, pavarësisht sa të pasherr ato mund të duken.

Z-ja ishte e vendosur në qëndrimin e saj, ndërsa unë tepër krenar për të pranuar se kisha gabuar. Nuk mund të arsyetoja gjithë atë reagim të saj, e tëra m'u duk shumë e tepruar, prandaj dhe u tregova kokëfortë, por kryelartësia ime, Z-së ia theu edhe më shumë zemrën. Mbase e tëra do të mund të zgjidhej me një "më fal" të sinqertë, me një hap përtej inatit të

çastit, por, kur më ra ndër mend të bëja këtë, tashmë ishte vonë. Sado që kisha dëshirë të besoja se isha ndryshe, në fund edhe unë isha bërë si të gjithë të tjerët që Z-ja i kishte njohur: egoist dhe kryelartë.

Z-ja nuk mundi më të më shihte njësoj si përpara. Pas kësaj, mes nesh u krijua një distancë që kulmoi me ndarjen tonë. I vetmi kontakt që më ngeli me të, ishin disa takime të rastësishme ku ajo gjithnjë më injoronte. I kam dërguar edhe një mori mesazhesh, por kot: ajo asnjëherë nuk më ktheu përgjigje.

Në ditët e para pasi Z-ja u largua, isha i bindur se mosmarrëveshja jonë do të ishte kalimtare. Besoja se ajo do të kthehej, kur e pashë se kjo nuk do të ndodhte, atëherë fillova të mendoj se me kohë do ta harroja dhe do të vazhdoja tutje. Edhe kjo ishte një lajthitje e radhës nga ana ime: Z-ja nuk u kthye, ndërsa unë nuk mund ta harroja atë.

Në një lojë të paparashikuar të fatit, tashmë jam brenda qerthullit të vetmisë sime.

INATI

(mesazh për Zonjën Z)

Edhe pse të lodhur nga shpërfillja e të dehur nga dhimbja, prapë nuk marrim guximin të ecim drejt njëri-tjetrit. Trembemi se hapi i parë do të shihet si dobësi, thuajse bëhemi gati për luftë dhe jo për dashuri.

Në pritje që diçka ta thyejë akullin mes nesh, përqafojmë heshtjen idiote. Atë që ka kohë për gjithçka, përveç që t'i hapë rrugë lumturisë. E ndërkohë, si të fiksuar, ndjekim profilin e njëri-tjetrit në Facebook, por me fanatizëm i kursejnë PËLQIMET se mos rastësisht po kuptohet se jemi duke menduar për njëri-tjetrin.

Çfarë budallenjsh krenarë!

Harrojmë se një PËLQIM nuk e shpreh as një të miliontën e mallit që tërë kohën shpërthen në flakë brenda nesh.

Nuk e di çfarë bën ti, por unë tërë kohën e shaj Zuckerberg-un, pse nuk ka shpikur një aplikacion që të ma bënte të mundur të përvidhem në zemrën tënde.

Dua të shoh kë dashuron vërtet.

A jam ende vetëm unë aty?

Apo ke lënë të hyjë dikë tjetër?

THYERJA

(mesazh për Zonjën Z)

Sa e lehtë është të thyhem!

Pyes veten: A jam edhe unë prej mishi e kocke apo jam prej qelqi?

Mjafton që dikush vetëm të të përmendë dhe mendja më arratiset.

Më kap një zjarrmi në shpirt, djersitem dhe mbështillem në ankth.

Dhe me krejt zërin ulëritj: Nuk e dua! Nuk e dua dhe nuk më plas fare për të!

I gënjej të gjithë.

Dua të dëgjosh edhe ti që të të gënjej edhe ty. Por më së shumti gënjej veten, sepse kur thyhen të gjitha shishet dhe askush më nuk ma vë veshin, atëherë dorëzohem.

E pranoj: Krejt çka dua, je vetëm ti!

KUFIRI

(mesazh për Zonjën Z)

Sa i hollë është kufiri mes urrejtjes dhe dashurisë.

Në ankthin e dhimbjes klith: Të urrej, sepse nuk mund të dashuroj askënd tjetër.

IKJA

(mesazh për Zonjën Z)

Si të shëroj vetminë?

Jam fshehur nëpër rrëmuja.

Jam dehur me të panjohur.

Jam lodhur duke shpikur angazhime të reja për veten.

Kam provuar të iki sa më larg nga ti.

Por ti gjithnjë je këtu.

Ti je jehona e jetës që dëgjohet në të gjitha kthinat e shpirtit tim.

Më trego, si ta shëroj vetminë?

DHIMBJA E DASHURISË

(mesazh për Zonjën Z)

Dhimbja e dashurisë.

Gërryen nga brenda.

Tejpërtej dhe drejt e në qendër të shpirtit.

Gërryen dhe nuk di të ndalet.

I kapërcen edhe kufijtë e çmendurisë.

Dhe përsëri nuk pushon.

Merr zjarr si një flakë e amshimit.

Digjet nga asgjëja dhe të shkrumbon në asgjë.

MALLI

(mesazh për Zonjën Z)

I ngulfatur nga kthetrat e zbrazëtisë.

Si i vdekur i pavetëdijshëm për errësirën.

Pa shpresë, i ngujuar në gjumin pa ëndrra.

E ftohtë është jeta,

pa ty!

EDHE NJËHERË NGA FILLIMI

(falët e fundit të Z-së)

Dikur pandehja se lumturia nuk i anashkalon ata që besojnë në dashuri e që natyrshëm janë të hareshëm. Por e hidhura e kësaj bote është se këta sfidohen më së shumti dhe nuk mund t'i shmangen përplasjes së vazhdueshme me shkëmbinjtë e pamëshirshëm dhe të thepisur të jetës. Ashtu jam përplasur dhe jam thyer e copëtuar kushedi sa herë edhe unë. Kjo nuk do të thotë se unë nuk besoj në dashuri. Përkundrazi! Veçse, tani besoj se zemra jeton në një botë tjetër që nuk ka lidhje me realitetin tonë. Në një botë ku koha nuk lëviz. Në një ëndërr ku gjithçka vazhdon të jetë e ngrirë në ndjenjat e magjisë së fillimit, atëherë kur gjithçka duket aq e lehtë. E tillë është një zemër që dashuron, e bukur në naivitetin e vet. Prandaj edhe vazhdon të dashurojë, madje edhe atëherë kur çdo gjë i thotë të kundërtën. Vazhdon të bëjë këtë derisa një ditë gjithçka që dikur ishte e bukur dhe plot me pasion, lodhet e shembet brenda vervetes.

Tërë jetën jam mbrojtur nga ata që kanë dashur të vjedhin diçka nga shpirti im dhe nga ata që kanë dashur të më ndryshojnë në thelb, duke më gjykuar pothuajse për çdo gjë. Por më së shumti jam përpjekur që të mbrohem nga dëshpërimi që më ka ndjekur pas sa herë jam ballafaquar me këta njerëz.

Nuk mundem më!

Para të tjerëve, i përmbaj lotët, por lotët e shpirtit, ata që derdhen brenda meje, janë shumë më të trishtueshëm, Rrjedhin si një lumë i nëndheshëm dhe i tërbuar që dufin e vet e shpërfaq pa rënë në sy.

Më parë e kisha shumë të lehtë ta bindja veten se mund të mësohesha të jetoja me dhimbjen brenda vetes. Thosha: "Ndrydhe dhimbjen. Përplase kudo që të mundesh."

Nuk mundem më!

E kam kuptuar si mund të jetohej me dhimbjen: frymon, derisa një ditë as këtë s'e bën dot më.

Duke shkuar nga trazimi në trazim, në fund fillon ta pyesësh veten: "A është dhimbja i vetmi specialitet në menunë e kësaj jete?" Ndihej e gërditur nga kjo mënyrë të jetuari.

Nuk mundem më!

Të gjithë kemi dëshirë të vlerësohemi për atë çka jemi me të vërtetë. Nuk duam që të tjerët të na shohin me sytë e botës, sepse e dimë që ata janë përplot me keqkuptime dhe intriga. Por, a nuk jemi edhe ne pjesë e botës? Apo gjithsecili nga ne reagon vetëm atëherë kur edhe vetë bëhet viktimë e tyre?

Jam lodhur nga hipokritët që e ushqejnë këtë botë smirëzezë.

Nuk mundem më!

E kam kuptuar se, sado që të përpiqet, një njeri i vetëm nuk mund ta ndryshojë botën. Një situatë diktron tjetrën dhe kështu vazhdon varg, aq sa në fund njeriu duhet të jetë i lumtur nëse së paku ia ka dalë që edhe vetë të mos bëhet ashtu siç është bota.

Edhe pse në shumëçka kam dështuar, shumë ëndrra janë arratisur nga unë dhe sot jetoj një jetë krejt ndryshe nga ajo që ëndërroja, nuk ndiej keqardhje a pendesë për ndonjë gjë. Nuk bëj pjesë në ata njerëz që mendojnë se, po të ktheheshin prapa në kohë, do të ndryshonin gjithçka. Që të ndryshoj unë dhe të bëj zgjedhje të tjera, do të duhej të ndryshonin edhe njerëzit përreth meje. Ndërkaq, u bë ç'u bë, kjo bota jonë e vogël nuk ndryshon, sepse, në fund, të gjithë do të bëjnë të njëjtat veprime. Dhe atëherë unë do të reagoj njësoj.

Ndihem e trishtuar.

Nuk shoh rrugëdalje.

Dhe për këtë ndonjëherë trembem.

E ndiej zjarrin në shpirt dhe acarin në gjoks.

Një flakë e gjallë që digjet brenda një kafazi të akullit.

Dua ta nxjerr zemrën nga kraharoni e ta lë të lirë.

Të lirë që të marrë malin, pa frikë se do ta gjykojnë si të çmendur.

Të lirë nga dhimbjet dhe trazimet, sepse e di që e nesërmja nuk do të sjellë asgjë të re.

Jam e lodhur nga jeta që vazhdon e rëndomtë kudo dhe kam filluar të kem frikë nga mendimet e mia. Nuk dua të përfundoj si disa që kanë rënë në dashuri me ëndrrën për lumturinë, ndërkaq nuk e jetojnë kurrë as dashurinë, as lumturinë.

Trembem nga gjumi, sepse e di që do të përtoj të zgjohem në mëngjes. Prandaj do të doja që sonte të mos isha fare këtu

dhe si me magji të zgjohesha diku tjetër. Diku ku do të mund ta nisja edhe njëherë nga fillimi.

PËRBALLJA E FUNDIT

Askush nuk di të tregojë saktë se çfarë ndodhi me Z-në. Dihet vetëm se ishte e premtë dhe deti shumë i trazuar, frynte erë e fortë dhe dallgët ishin të larta e të fuqishme. Gjithçka kishin gjetur janë rrobat e saj që i kishte zhveshur para se të futej në det dhe librin tim të preferuar "Ditari sekret" i Pushkinit, në mes të fletëve të të cilit kishin gjetur edhe letrën e saj të lamtumirës. Shumëkush kishte pyetur pse kishte zgjedhur pikërisht atë libër, por unë e dija të vërtetën: ishte mesazh për mua.

Z-ja asnjëherë nuk kishte besuar në zgjidhje të lehta, prandaj nuk kishte zgjedhur litarin, një plumb në tëmth, të pinte një grumbull me hape apo diçka tjetër të ngjashme.

Ajo zgjodhi të luftonte edhe në aktin e saj të fundit dhe nga kjo botë parapëlqeu të dilte me një përballje të lodhshme dhe të frikshme me dallgët e detit. Më duket se e shoh duke u kacafytur me fuqinë e llahtarshme të stuhisë, duke dashur që edhe në atë situatë të dëshmonte se ajo ishte ndryshe nga gjithë të tjerët.

Gjithnjë kam dyshuar në motivin e vërtetë pse Z-ja kishte vendosur që të mos i shkruante më bisedat tona. Arsyetimi i saj se trembej se të tjerët do të frymëzoheshin në rebelim, asnjëherë nuk më është dukur bindës. Kur tani i lexoj tri shënimet e fundit të saj e ndiej se ajo e kishte ndarë mendjen qysh më herët. Z-ja

thjesht kishte kohë që nuk ndihej pjesë e kësaj bote dhe ishte ngopur me dhimbjen dhe lodhjen shpirtërore që shoqëria jonë gjithnjë ia servirte.

Kjo botë jona, shumë e vogël në pamje dhe shtrirje, por me një ego të madhe, të stërm bushur me smirë, intriga dhe energji negative për çdo gjë dhe për hiçgjë, thjesht nuk pati vend për dikë si Z-ja. Dhe ajo e dinte. Ashtu siç dinte se ky rrethi ynë ta pranon vlerën vetëm pasi më parë të dërrmon e të copëton shpirtin; nuk i kursen fjalët e mira vetëm kur të heq qafe dhe të thur himne vetëm kur të vdesësh.

Ndihem shumë keq që nuk i dhashë rëndësinë e duhur hidhërimit të saj me gënjeshtren time. Z-ja kishte nevojë të madhe që çdo gjë mes nesh të ishte e vërtetë, të ishte ndryshe nga çdo gjë tjetër. Por, në të njëjtën kohë, një zë brenda meje më thotë se Z-ja e ka ditur se unë nuk do të mund t'i shkatërroja shënimet e saj, prandaj dhe më furi në atë situatë. Një kurth dinak që të gjente një arsye për të më larguar nga vetja, në mënyrë që ajo të mund të vazhdonte me synimin e saj.

Edhe pse ndiej shumë dhimbje, nuk ndihem i trishtuar. Ndihem sikur ajo përsëri më ka vënë në sprovë nëse do të kem forcë të përballem me lukuninë që e çoi drejt vendimit fatal. Ndihem i mllëfësuar kundër të gjithë atyre që drejtuan gishtin mbi shpirtin e saj të lirë. Ndihem i tërbuar kundër atyre që nuk bënë as përpjekjen më të vogël për ta kuptuar.

Por pyetja që asesi nuk i bishtnoj dot është: a mos vallë edhe unë jam pak fajtor?


MESAZHI I FUNDIT PËR Z-në

Pas teje, nuk dua të dashuroj më askënd tjetër.

Jo se nuk do të mundem.

Jo se nuk do të di, por, në çastin kur ike ti, çdo gjë e bukur iku bashkë me ty.

Dua të harroj edhe si dashurohet.



[illegible]

Case	α	β	γ	δ	ϵ	ζ	η	θ	ι	κ	λ	μ	ν	ξ	$\omicron$	π	ρ	σ	τ	υ	ϕ	χ	ψ	ω	
1	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
2	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
3	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
4	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
5	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
6	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
7	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
8	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
9	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
10	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
11	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
12	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
13	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000
14	0.000	0.000	0.																						